AASF
Albania Agribusiness Support Facility

European Bank
for Reconstruction and Development

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë

Udhëzues
praktik mbi

# KARTAT TEKNOLOGJIKE NË BUJQËSI



Studim financiar dhe agro-teknik mbi strukturën e kostove dhe të ardhurat në fermë për aktivitete të ndryshme bujqësore

Udhëzues
praktik mbi

# KARTAT TEKNOLOGJIKE NË BUJQËSI

Albania Agribusiness Support Facility

**AASF Project Office**
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 294 1513
www.aasf.al
Info@aasf.al

Karta Teknologjike Bujqësore është një produkt inovativ, i përshtatur për të zbutur boshllëkun e informacionit me të cilin ballafaqohet agrobiznesi në Shqipëri, si dhe për të krijuar platforma efikase kordinimi me aktorët kryesorë në ekosistemin bujqësor, si institucionet financiar, shërbimin e ekstensionit, furnitorët e inputeve, ekspertët e zinxhirit të vlerës etj.

Për përgatitjen e Kartave Teknologjike një falënderim i veçantë i dedikohet fermerëve dhe ekspertëve të bujqësisë në Fier, Lushnje, Divjakë, Korçë, Peshkopi dhe rajone të tjera të Shqipërisë. Pa opinionet e tyre profesionale dhe informacionet e sakta, zhvillimi i kartave teknologjike nuk do të ishte i mundur. Furnizuesit e inputeve kanë pasur gjithashtu një rol të rëndësishëm me informacionet e tyre mbi çmimet e inputeve të cilat kanë shërbyer si variabla kontrolli për çmimet e deklaruara nga fermerët dhe ekspertët. Dhe sëfundmi stafi i Departamentit të Agrobiznesit në CBS ka dhënë një kontribut të çmuar në grumbullimin dhe përpunimin e informacionit si edhe zhvillimin e analizave përshkruese për secilën kartë teknologjike.

*Autorët*

# PËRMBAJTJA

1. **Kartat teknologjike** .......... **7**

2. **Qëllimi i hartimit të Kartave Teknologjike** .......... **7**

3. **Rëndësia për grupet e synuara** .......... **8**

4. **Mbledhja e të dhënave dhe analiza** .......... **9**

5. **Kartat Teknologjike të prodhimeve në serra inpute me pakicë** .......... **11**

- *Karta teknologjike - Domate serre - Kulturë e parë* .......... *12*
- *Karta teknologjike - Domate serre – Kulturë e dytë* .......... *14*
- *Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e parë* .......... *16*
- *Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e dytë* .......... *18*
- *Karta teknologjike - Speca në serrë - Cikël i gjatë* .......... *20*
- *Karta teknologjike - Patëllxhan në serrë - Cikël i gjatë* .......... *22*
- *Karta teknologjike - Kungulleshka në serrë - Cikël i gjatë* .......... *24*
- *Karta teknologjike - Luleshtrydhe në serrë* .......... *26*

6. **Kartat Teknologjike të prodhimeve në serra inpute me shumicë** .......... **29**

- *Karta teknologjike - Domate serre - Kulturë e parë* .......... *30*
- *Karta teknologjike - Domate serre - Kulturë e dytë* .......... *32*
- *Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e parë* .......... *34*
- *Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e dytë* .......... *36*
- *Karta teknologjike - Speca në serrë - Cikël i gjatë* .......... *38*
- *Karta teknologjike - Patëllxhan në serrë - Cikël i gjatë* .......... *40*
- *Karta teknologjike - Kungulleshka në serrë - Cikël i gjatë* .......... *42*
- *Karta teknologjike - Luleshtrydhe në serë* .......... *44*

7. **Kartat Teknologjike të prodhimeve në fushë inpute me pakicë** .......... **47**

- *Karta teknologjike - Domate fushe* .......... *48*
- *Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e parë* .......... *50*
- *Karta teknologjike - Karrotë* .......... *52*

- *Karta teknologjike - Lulelakër* ........ 54
- *Karta teknologjike - Brokoli* ........ 56
- *Karta teknologjike - Lakër kokë* ........ 58
- *Karta teknologjike - Patate* ........ 60
- *Karta teknologjike - Shalqi në tunele* ........ 62
- *Karta teknologjike - Shalqi i vonë* ........ 64
- *Karta teknologjike - Pjepër në tunele* ........ 66
- *Karta teknologjike - Qepë* ........ 68

8. **Kartat Teknologjike të pemëve frutore inpute me pakicë ........ 71**

- *Karta teknologjike - Mollë - Kultivim intensiv* ........ 72
- *Karta teknologjike - Mollë – Kultivim intensiv* ........ 74
- *Karta teknologjike - Dardhë - Kultivim intensiv* ........ 76
- *Karta teknologjike - Qershi - Kultivim intensiv* ........ 78
- *Karta teknologjike - Pjeshkë dhe nektarinë* ........ 80
- *Karta teknologjike - Mandarina* ........ 82
- *Karta teknologjike - Shegë* ........ 84
- *Karta teknologjike - Lajthi* ........ 86
- *Karta teknologjike - Arra* ........ 88
- *Karta teknologjike - Ulliri* ........ 90
- *Karta teknologjike - Rrush tavoline* ........ 92
- *Karta teknologjike - Rrush për verë* ........ 94

9. **Kartat Teknologjike e gjedhit ........ 97**

- *Karta teknologjike - Fermë gjedhi - 10 lopë qumështi* ........ 98

10. **Lista e çmimeve mesatare të inputeve nga disa furnizues të mëdhenj ........ 101**

11. **Konkluzione ........ 111**

12. **Analizë përmbledhëse e treguesve kryesor nga Kartat Teknologjike ........ 112**

# KARTAT TEKNOLOGJIKE

## Qëllimi i hartimit të Kartave Teknologjike

Karta Teknologjike Bujqësore është një produkt inovativ, i përshtatur për të zbutur boshllëkun e informacionit me të cilin ballafaqohet agrobiznesi në Shqipëri, si dhe për të krijuar platforma efikase koordinimi me aktorët kryesorë në ekosistemin bujqësor, si institucionet financiare, shërbimin e ekstensionit, furnitorët e imputeve, ekspertët e zinxhirit të vlerës, etj. Përgatitja e Kartave Teknologjike është hartuar si një zgjidhje e bërë në mënyrë specifike për aktivitetet bujqësore të përzgjedhura të cilat do furnizohen në mënyrë të vazhdueshme me informacionin e duhur lokal.

Zbatimi i Kartave Teknologjike nga njëra anë do të rrisë nivelin e ekspertizës dhe njohurive për institucionet financiare që kërkojnë të rrisin portofolet e kreditimit agro duke reduktuar risk - un përmes një procesi vendimmarrës bazuar në evidenca. Nga ana tjetër, Karta Teknologjike është një produkt i dobishëm për vetë fermerët, pasi i ndihmon ata të aplikojnë shërbime agro - teknike në mënyrë efikase duke reduktuar humbjet apo shpenzimet e tepërta në fermë, rezultati i të cilave sjell fitime më të larta.

Karta Teknologjike përmban standarde mesatare të prodhimit, koston mesatare të prodhimit në një nivel të caktuar të imputeve, proceseve të prodhimit dhe llogarit marzhet mesatare neto të produkteve të ndryshme bujqësore, të cilat janë thelbësore për të kryer analizën sasiore.

Qëllimi në vetvete i Kartave Teknologjike është të sigurojë një informacion të hollësishëm rreth strukturës së kostos dhe të ardhurave mbi kultivimin e produkteve të ndryshme bujqësore në nivel ferme për një nivel të caktuar të prodhimit në një sipërfaqe të caktuar. Analiza fokusohet në ofrimin e informacionit të detajuar dhe të saktë rreth kostove dhe të ardhurave të prodhimit për 25 produkte bujqësore potenciale të kultivuara në një sipërfaqe prej 1 ha.

Karta teknologjike përmban përshkrime të hollësishme të imputeve, pesticideve, plehrave, punës së mekanizuar, kostos së punës me krahë (ditë), energji elektrike, ujë dhe kostot e tjera të prodhimit. Kostot e prodhimit jane të ndara në kosto fikse dhe variable. Gjithashtu, kostot e prodhimit janë shpërndarë sipas ciklit të prodhimit, dhe kjo do të sigurojë një informacion të rëndësishëm për audiencën e synuar për të kuptuar më mirë sezonalitetin e prodhimit për secilin produkt dhe domosdoshmërinë e financimit në faza të ndryshme.

Disa nga treguesit kryesorë që analizohen në Kartën Teknologjike janë:

- • Kosto variable totale për ha;
- • Kosto fikse totale për ha;
- • Kosto totale e prodhimit për ha;
- • Kosto e prodhimit për kg;
- • Ndarja e prodhimit sipas cilësisë në kg;
- • Të ardhurat për ha;
- • Fitimi neto për ha;
- • Çmimi në pikën kritike për kg, (i barabartë me koston e prodhimit për kg);
- • Rendimenti i prodhimit në pikën kritike për ha;
- • Produktiviteti për ditë pune.

**Rëndësia për grupet e synuara**

Të dhënat e Kartës Teknologjike i shërbejnë fermerëve, ofruesve të shërbimeve, për të kuptuar më mirë sektorin bujqësor dhe për të vlerësuar më saktë operacionet e fermës. Kjo do t'u lejojë prodhuesve të studiojnë operacionet në fermë dhe ta krahasojnë atë me praktikat më të mira të fermave të zhvilluara. Karta Teknologjike ndihmon fermerët në përmirësimin e vendimmarrjes, efikasitetit dhe performancës së tregut.

Karta Teknologjike ofron informacion të dobishëm për kompanitë që ofrojnë shërbime për fermerët, duke përfshirë sistemin bankar dhe kompanitë e sigurimeve.

Të dhënat në nivel ferme në lidhje me kostot dhe të ardhurat u mundësojnë analistëve të fermës, qofshin ata drejtues, agjentë terreni ose analistë të politikave, për të vlerësuar efektet e vendimeve të menaxhimit në efikasitetin e fermës, të ardhurat dhe rentabilitetin, si dhe të këshillojnë fermerët në përputhje me rrethanat e caktuara.

Kartat Teknologjike do t'i shërbejnë sektorit bankar për të krijuar një tablo të qartë të parashikimeve të rrjedhës së parave në aktivitete të ndryshme bujqësore, kalendarët e zhvillimit të aktiviteteve dhe risqet kryesore. Nëpërmjet këtij materiali sistemi bankar do të trajtojë më nga afër kërkesat e sipërmarrjes bujqësore për huadhënie, mënyrën e strukturimit të pagesave bankare, përditësimin e politikave dhe proceseve të kreditimit për të siguruar që përveç vlerësimeve standarde financiare të analizohen dhe faktorë të veçantë bujqësorë.

Aksesi në të dhëna të sakta mbi kostot dhe të ardhurat lehtëson vlerësimet mbi risqet financiare që lidhen me prodhimin bujqësor. Përmes aftësisë për të vlerësuar një huamarrës të mundshëm në aspektin e kostove dhe kthimit të prodhimit/investimit, sektori financiar do të mundësojë në dizenjimin më të mirë të produkteve financiare për nevojat e fermerëve.

Informacioni i kartave teknologjike do të shërbejë si informacion i dobishëm për politikëbërësit për të përmirësuar efikasitetin e politikave bujqësore. Ofrimi i të dhënave të sakta dhe të detajuara është i nevojshëm për të kuptuar në mënyrë të përshtatshme proceset themelore që ndikojnë produktivitetin e këtij sektori dhe ndikimin e mundshëm të politikave dhe rregulloreve të reja.

## Mbledhja e të dhënave dhe analiza

Duke pasur parasysh natyrën e të dhënave dhe informacionit të siguruar, analiza ka natyrë kryesisht sasiore. Analiza siguron informacion të saktë në lidhje me sasitë dhe çmimet e produkteve të përzgjedhur, kostot e prodhimit, informacion të hollësishëm rreth rendimenteve të pritshme dhe çmimeve të shitjes bazuar në teknologjinë e aplikuar. Gjithashtu, llogariten kostot e përafërta të prodhimit dhe fitimet në fermë.

Studimi për zhvillimin e kartave të detajuara teknologjike bazohet kryesisht në të dhënat primare të mbledhura nga intervistat me fermerë me eksperiencë, tregtuesit me shumicë dhe pakicë të imputeve bujqësore, agronomë dhe ekspertë të tjerë në sektorin e bujqësisë. Gjithashtu, janë përdorur edhe të dhëna dytësore në përputhje me rrethanat, si një informacion plotësues i kombinuar me të dhënat primare.

**Të dhënat primare** për zhvillimin e kartave teknologjike janë grumbulluar nga hulumtimi në terren duke përdorur "Intervista Omnibus", që mbulojnë një gamë të gjerë aktorësh të tregut, si fermerë me përvojë, furnizues të imputeve, agronomë dhe ekspertë të tjerë në terren. Intervistat Omnibus ose shumëqëllimshe grumbullojnë të dhëna për çështje të ndryshme, por të lidhura me - tjetrën duke përdorur një mjet unik të mbledhjes së të dhënave.

Është përdorur një metodologji përzgjedhjeje jorastësore për të identifikuar aktorët kryesorë të tregut, të cilët janë intervistuar për produktet e përzgjedhura. Në një përzgjedhje jo të rastësishme aktorët të cilët u intervistuan u përzgjodhën me kujdes në bazë të rëndësisë së tyre në lidhje me aktivitetin bujqësor, aftësinë e tyre për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme, interesin e tyre për studimin, përfaqësueshmërinë ndaj të gjithë sektorit, (ferma të cilat përfaqësojnë karakteristikat më të zakonshme të fermave në rajon), etj.

**Të dhënat dytësore** janë përdorur si informacion ndihmës për të vlerësuar më mirë kostot dhe të ardhurat. Këto burime janë në thelb informacione administrative, (të dhëna mbi taksat, të dhëna kadastrale, etj.) dhe të dhëna të tregut për imputet, (çmimet e imputeve dhe plehrave, pagesat në bujqësi, etj.). Këto të dhëna u përdorën në kombinim me të dhënat primare në rast të informacionit të paplotë, (p.sh. të dhënat mungojnë në vlera, por janë në dispozicion në vëllime). Disa nga burimet kryesore që janë përdorur për sigurimin e të dhënave dytësorë janë: AGIS, INSTAT, FAOSTAT.

Shënime:

# KARTAT TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMEVE NË SERRA INPUTE ME PAKICË



# Karta teknologjike - Domate serre - Kulturë e parë – Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Njohja e strukturës së prodhimit dhe të ardhurave të kulturave bujqësore përbën një rëndësi të madhe për politikëbërësit, institucionet financiare, shërbimet e ekstensionit dhe për vetë fermerët dhe agrobizneset. Në këtë seksion shpjegohet karta teknologjike për prodhimin e domates në serra të thjeshta diellore, kulturë e parë në një sipërfaqe prej 1 hektar. Vlerat e paraqitura në tabelë janë shifra mesatare të konsultuara me ekspertë, ekstensionistë, fermerë dhe tregtarë të imputeve bujqësore.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera kostoja totale për kultivimin e 1 ha domate në serra kulturë e parë janë rreth 2 789 550 lekë. Nga totali i kostove 2 566 350 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 223 000 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve të nevojshme me 54.1% të totalit të kostove. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 25.8% e totalit të kostove të prodhimit.

Kostot fikse lidhen me amortizimin vjetor të serrës, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksën e tokës. Arritja e një rendimenti sa më të lartë, sigurisht duke ruajtur cilësinë e duhur do të reduktonte kostot fikse duke rritur kështu të ardhurat dhe fitimin.Në grafikun e mëposhtëm paraqitet struktura e plotë e kostove të prodhimit.

## Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i domates në serra gjeneron të ardhura relativisht të larta, duke tërhequr gjithnjë e më shumë investime në këtë sektor. Kultivimi i domates në serra kulturë e parë, në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 100 ton dhe një të ardhur prej 4 300 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (80 ton), janë llogaritur me një çmim 45 lek/kg, ndërsa shitjet nga ciilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 35 lek/kg.

## Kreditimi

Kreditimi nga institucionet financiare është shumë i rëndësishëm për fermat në fazën e nisjes së procesit të prodhimit. Kreditimi në formën e kapitalit qarkullues nevojitet në muajin dhjetor, muaj në të cilin fillon edhe sezoni i prodhimit. Fermerët mund të nisin të shlyejnë kredinë duke filluar nga muaji prill, muaj në të cilin fillojnë të arkëtojnë nga shitjet. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

## Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Pavarësisht faktit se shifrat e të ardhurave dhe shpenzimeve japin informacion të rëndësishëm mbi një fermë, analizimi i disa treguesve kryesorë ofron një pasqyrë më të qartë mbi rendimentet, produktivitetin e punës, marzhin e fitimit, etj.

- **Fitimi neto:** 1 510 450 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 64 873 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 138.89 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 27.9 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 35.1%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkti më i rëndësishëm në grupin e perimeve në terma të prodhimit dhe konsumit.
- Traditë e vjetër në kultivim.
- Rajonet kryesore: Fier, Lushnja, Divjaka, Berat, Elbasan, Shkodër, Durrës; (burimi: AGIS).
- Mbështetje e madhe nga programet e granteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rritje e shpejtë e sipërfaqes me domate në serra.
- Interes i lartë për investime nxitur nga marzhet e larta të fitimit.
- Produkti më i eksportuar në grupin e fruta – perimeve, (63 700 ton - 24.6 mln USD).
- Kërkesë gjithnjë e më e lartë nga tregjet botërore, por plotësimi standarteve të larta si Global Gap është domosdoshmeri.

| Paketa teknologjike për prodhimin e domates në serrë - Kulturë e parë - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë) | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emertimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
| | | | | | | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | | |
| ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **40,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | | | *0.4* | 1.4% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | | 20,000 | | | | | | *0.2* | 0.7% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 20 | **3,500** | 70,000 | | 7,000 | 14,000 | 17,500 | 17,500 | 14,000 | | *0.7* | 2.5% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **130,000** | | | | | | | | ***1.3*** | **4.7%** |
| ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | *0.2* | 0.7% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | *0.3* | 1.1% |
| 3 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | | 10,000 | | | | | | *0.1* | 0.4% |
| 4 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | | 20,000 | | | | | | *0.2* | 0.7% |
| 5 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | | 15,000 | 15,000 | | | | | *0.3* | 1.1% |
| 6 | *Shërbime gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | | | 56,000 | 56,000 | 56,000 | 112,000 | | *2.8* | 10.0% |
| 7 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | | | | | 84,000 | 126,000 | 70,000 | *2.8* | 10.0% |
| 8 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 50 | **1,000** | 50,000 | | | | | 15,000 | 22,500 | 12,500 | *0.5* | 1.8% |
| | Totali punimeve me krahë | | **720** | | **720,000** | | | | | | | | ***7.2*** | **25.8%** |
| ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 25,000 | **26** | 650,000 | | 650,000 | | | | | | *6.5* | 23.3% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 100 | **1,660** | 166,000 | 166,000 | | | | | | | *1.7* | 6.0% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | | 91,000 | | | | | | *0.9* | 3.3% |
| 4 | *Plehera kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 600 | **280** | 168,000 | | 25,200 | 42,000 | 50,400 | 25,200 | 25,200 | | *1.7* | 6.0% |
| 5 | *Plehëra gjethore* | kg | 15 | **2,000** | 30,000 | | | | 3,000 | 9,000 | 12,000 | 6,000 | *0.3* | 1.1% |
| 6 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | | | *0.2* | 0.6% |
| 7 | *Fungicide* | kg | 25 | **6,000** | 150,000 | | 15,000 | 15,000 | 45,000 | 45,000 | 30,000 | | *1.5* | 5.4% |
| 8 | *Insekticide* | kg | 10 | **9,000** | 90,000 | | 9,000 | 9,000 | 27,000 | 27,000 | 18,000 | | *0.9* | 3.2% |
| 9 | *Bletë pjalmuese* | koshere | 6 | **15,000** | 90,000 | | | | 90,000 | | | | *0.9* | 3.2% |
| 10 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **6** | 36,000 | 36,000 | | | | | | | *0.4* | 1.3% |
| 11 | *Spango për lidhje* | copë | 5 | **4,500** | 22,500 | | 11,250 | 11,250 | | | | | *0.2* | 0.8% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **1,509,750** | | | | | | | | ***15.1*** | **54.1%** |
| ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 2,400 | **14.0** | 33,600 | | 3,360 | 5,040 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 5,040 | *0.3* | 1.2% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 4,000 | **5** | 20,000 | | 2,000 | 3,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 3,000 | *0.2* | 0.7% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 10 | **2,500** | 25,000 | | 5,000 | 5,000 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | *0.3* | 0.9% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | *0.8* | 3.0% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | *0.1* | 0.5% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | | *0.3* | 1.1% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **206,600** | | | | | | | | ***2.1*** | **7.4%** |
| ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serrës* | lekë | | | 200,000 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | *2.0* | 7.2% |
| 2 | *Sigurimet shoqerore* | lekë | | | 19,200 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | *0.2* | 0.7% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | *0.0* | 0.1% |
| Totali i kostove fikse | | | | | **223,200** | | | | | | | | ***2.2*** | **8.0%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 2,566,350 | | | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 223,200 | | | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **2,789,550** | **438,136** | **921,696** | **213,176** | **341,256** | **331,056** | **412,056** | **132,176** | ***27.9*** | **100%** |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia I | | kg | 80,000 | **45** | 3,600,000 | | | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia II | | kg | 20,000 | **35** | 700,000 | | | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **4,300,000** | | | | | | | | | |
| ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | | ***1,510,450*** | | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | ***27.9*** | | | | |
| ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | | ***64,873*** | | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | ***43.0*** | | | | |
| ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | | ***138.89*** | | ***Marzhi i fitimit*** | | | ***35.1%*** | | | | |



# Karta teknologjike - Domate serre – Kulturë e dytë – Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Pas përfundimit të ciklit të parë të prodhimit dhe shitjes së domates, fermerët fokusohen në përgatitjet e nevojshme për fillimin e ciklit të dytë të prodhimit. Ashtu si në ciklin e parë, edhe në ciklin e dytë të prodhimit njohja e strukturës së shpenzimeve dhe të ardhurave përbën një rëndësi të veçantë për një numër të madh aktorësh. Në këtë seksion shpjegohet karta teknologjike për prodhimin e domates në serra, kulturë e dytë në një sipërfaqe prej 1 hektar, skenari i imputeve me pakicë. Vlerat e paraqitura në tabelë janë shifra mesatare të konsultuara me ekspertë, ekstensionistë, fermerë dhe tregtarë të imputeve bujqësore.

## Kostot e prodhimit

Kultivimi i domates si kulturë e dytë në një sipërfaqe prej 1 ha duke përdorur impute me pakicë ka një kosto rreth 2 120 150 lekë. Nga totali i kostove 1 896 950 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 223 000 lekë janë kosto fikse. Ashtu si në rastin e domates kulturë e parë, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve të nevojshme me 51.2% të totalit të kostove. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 28.3% e totalit të kostove të prodhimit.

Kostot fikse lidhen me amortizimin vjetor të serrës, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksën e tokës. Rendimenti në kulturën e dytë është zakonisht më i ulët se në ciklin e parë të prodhimit, kryesisht për shkak të ndryshimeve klimatike pranverë -vjeshtë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet struktura e plotë e kostove të prodhimit.

**Struktura e kostove**




## Të ardhurat

Kultivimi i domates në serra gjeneron të ardhura relativisht të larta si në ciklin e parë, edhe në ciklin e dytë të prodhimit duke e bërë kultivimin e saj atraktiv për shumë ferma në gjithë Shqipërinë. Kultivimi i domates në serra kulturë e dytë, në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 80 ton dhe një të ardhur prej 3 700 00 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (60 ton), janë llogaritur më një çmim 50 lek/kg, ndërsa shitjet nga ciilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 35 lek/kg.

## Kreditimi

Kreditimi nga institucionet financiare është shumë i rëndësishëm për fermat në fazën e nisjes së procesit të prodhimit. Kreditimi nevojitet kryesisht për kapital qarkullues, i cili konsiston ne blerjen e fidanit dhe imputeve bujqesore. Periudha më e përshtatshme për shlyerjen e kredisë në ciklin e dytë të prodhimit është periudha 15 nëntor deri në fund të dhjetorit.

**Grafiku kohor i kreditimit**




## Treguesit kryesorë

Treguesit financiarë dhe ato të rendimenteve janë të rëndësishme për të kuptuar, nëse ferma po operon me efiçience dhe po gjeneron fitime. Disa nga treguesit kryesorë për kultivimin e domates në sezonin e vjeshtës, paraqiten më poshtë:

- **Fitimi neto:** 1 579 850 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 45 841 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 133.33 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 26.5 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 42.7%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkti më i rëndësishëm në grupin e perimeve në terma të prodhimit dhe konsumit.
- Traditë e vjetër në kultivim.
- Rajonet kryesore: Fier, Lushnje, Divjake, Berat, Elbasan, Durrës; (burimi: AGIS).
- Mbështetje e madhe nga programet e granteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rritje e shpejtë e sipërfaqes me domate në serra.
- Interes i lartë për investime nxitur nga marzhet e larta të fitimit.
- Produkti më i eksportuar në grupin e fruta – perimeve, (63 700 ton - 24.6 mln USD).
- Kërkesë gjithnjë e më e lartë nga tregjet, por plotësimi i standarteve të larta, si Global Gap është domosdoshmëri.

**Paketa teknologjike për prodhimin e domates në serrë - Kulturë e dytë - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë)**

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **40,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | *2.0* | 1.9% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *1.0* | 0.9% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 16 | **3,500** | 56,000 | 5,600 | 5,600 | 14,000 | 16,800 | 14,000 | *2.8* | 2.6% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **116,000** | | | | | | ***5.8*** | **5.5%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *1.0* | 0.9% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | | 10,000 | | | | *0.5* | 0.5% |
| 3 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | | 10,000 | 10,000 | | | *1.0* | 0.9% |
| 4 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | | | 30,000 | | | *1.5* | 1.4% |
| 5 | *Shërbime gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 240 | **1,000** | 240,000 | | | 48,000 | 96,000 | 96,000 | *12.0* | 11.3% |
| 6 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 240 | **1,000** | 240,000 | | | 48,000 | 96,000 | 96,000 | *12.0* | 11.3% |
| 7 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | | | 8,000 | 16,000 | 16,000 | *2.0* | 1.9% |
| | Totali punimeve me krahë | | **600** | | **600,000** | | | | | | ***30.0*** | **28.3%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 25,000 | **18** | 450,000 | 450,000 | | | | | *22.5* | 21.2% |
| 2 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | 91,000 | | | | | *4.6* | 4.3% |
| 3 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 600 | **280** | 168,000 | | 33,600 | 50,400 | 50,400 | 33,600 | *8.4* | 7.9% |
| 4 | *Plehëra gjethore* | kg | 10 | **2,000** | 20,000 | | | 4,000 | 8,000 | 8,000 | *1.0* | 0.9% |
| 5 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | *0.8* | 0.8% |
| 6 | *Fungicide* | kg | 20 | **6,000** | 120,000 | | 12,000 | 36,000 | 36,000 | 36,000 | *6.0* | 5.7% |
| 7 | *Insekticide* | kg | 8 | **9,000** | 72,000 | | 14,400 | 14,400 | 21,600 | 21,600 | *3.6* | 3.4% |
| 8 | *Bletë pjalmuese* | koshere | 6 | **15,000** | 90,000 | | | 90,000 | | | *4.5* | 4.2% |
| 9 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **6.0** | 36,000 | 36,000 | | | | | *1.8* | 1.7% |
| 10 | *Spango për lidhje* | copë | 5 | **4,500** | 22,500 | | 11,250 | 11,250 | | | *1.1* | 1.1% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **1,085,750** | | | | | | ***54.3*** | **51.2%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 1,800 | **14.0** | 25,200 | 7,560 | 7,560 | 3,780 | 3,780 | 2,520 | *1.3* | 1.2% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 3,000 | **5.0** | 15,000 | 4,500 | 4,500 | 2,250 | 2,250 | 1,500 | *0.8* | 0.7% |
| 3 | *Transport i inputeve në ferme* | rrugë | 10 | **2,500** | 25,000 | 7,500 | 6,250 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | *1.3* | 1.2% |
| 4 | *Të paparishikuara* | leke | 1 | **30,000** | 30,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | *1.5* | 1.4% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **95,200** | | | | | | ***4.8*** | **4.5%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serrës* | lekë | | | 200,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | *10.0* | 9.4% |
| 2 | *Sigurimet shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *1.0* | 0.9% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.2* | 0.2% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **223,200** | | | | | | ***11.2*** | **10.5%** |
| | Total i kostove variable (A+B+C+D) | lekë | | | 1,896,950 | | | | | | | |
| | Total i kostove fikse (E) | lekë | | | 223,200 | | | | | | | |
| | **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | lekë | | | **2,120,150** | **749,050** | **165,800** | **424,470** | **401,220** | **379,610** | ***26.5*** | 100% |
| | Të ardhurat nga shitjet cilësia I | kg | 60,000 | **50** | 3,000,000 | | | | | | | |
| | Të ardhurat nga shitjet cilësia II | kg | 20,000 | **35** | 700,000 | | | | | | | |
| | **Të ardhurat totale** | lekë | | | **3,700,000** | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | ***1,579,850*** | | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | ***26.5*** | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***45,841*** | | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | ***46.3*** | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***133.33*** | | ***Marzhi i fitimit*** | | | ***42.7%*** | | |



# Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e parë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Duke qenë produkti i dytë më e rëndësishëm i kultivuar në mjedise të mbrojtura pas domates, njohja e shpenzimeve dhe të ardhurave për kastravecin në serra përbën rëndësi të veçantë për shumë aktorë, përfshi edhe vetë fermerët. Në këtë seksion trajtohet struktura e kostove të prodhimit dhe të ardhurat për kultivimin e kastravecit në serra, kulturë e parë në skenarin e blerjes së imputeve me pakicë në sipërfaqe 1 hektar. Gjithashtu analizohet nevoja për kreditim, treguesit kryesorë ekonomikë, si edhe karakteristikat dhe potencialet e kastravecit në serra.

## Kostot e prodhimit

Kultivimi i kastravecit si kulturë e parë në një sipërfaqe prej 1 ha duke përdorur impute me pakicë ka një kosto totale prej 2 526 550 lekë. Nga totali i kostove 2 303 350 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 223 000 lekë janë kosto fikse. Blerja e imputeve dhe materialeve zënë pjesën më të madhe në strukturën e kostove me 52.4%, ndjekur nga kostot e fuqisë punëtore me 25.1%.

Njësoj si në rastin e domates, kostot fikse lidhen me amortizimin vjetor të serrës, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksën e tokës. Fakti që kostot fikse janë relativisht të ulëta përbën një avantazh për fermat, pasi nuk kanë presionin e arritjes së rendimenteve sa më të larta dhe mund të fokusohen në arritjen e një cilësie maksimale.

## Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i kastravecit në serra gjeneron të ardhura relativisht të larta, si në ciklin e parë, edhe në ciklin e dytë të prodhimit duke e bërë kultivimin e tij atraktiv për shumë ferma në gjithë Shqipërinë. Kultivimi i kastravecit në serra, kulturë e parë në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 90 ton dhe një të ardhur prej 3 950 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (70 ton), janë llogaritur me një çmim 45 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 40 lek/kg.

## Kreditimi

Në fillim të procesit të prodhimit të kastravecit në serra fermerët kanë nevojë për kreditim, kryesisht në formën e kapitalit qarkullues. Kreditimi ndihmon në blerjen e imputeve, farave dhe materialeve të ndryshme të nevojshme. Zakonisht ky kreditim nevojitet në muajin dhjetor, periudhë në të cilin nis edhe procesi i prodhimit. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

## Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Për të ndihmuar në procesin e vendimmarrjes dhe një arsyetim më të saktë mbi përfitueshmërinë ekonomike, përveç të ardhurave dhe shpenzimeve ka edhe tregues të tjerë të rëndësishëm, të cilët janë paraqitur më poshtë:

- **Fitimi neto:** 1 423 450 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 57 567 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 141.73 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 28.1 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 36.0%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkti i dytë më i rëndësishëm në grupin e perimeve në serra, në terma të prodhimit.
- Njohuri të mira dhe eksperiencë e gjatë në kultivim.
- Rajonet kryesore: Fier, Berat, Elbasan, Durrës, Shkodër; (burimi: AGIS).
- Mbështetje e madhe nga programet e granteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rritje e shpejtë e sipërfaqes së kultivuar.
- Marzhe të larta fitimi.
- Eksportet me rritje eksponenciale, (+11,000 ton në 5 vitet e fundit).
- Kërkesë e lartë në tregjet e zhvilluara të Perëndimit, por plotësimi i standardeve të larta, si Global Gap është domosdoshmëri.

| Paketa teknologjike për prodhimin e kastravecit në serrë - Kulture e parë - Siperfaqja 1 ha (inpute me pakicë) | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi /njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
| | | | | | | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **40,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | | | *2.0* | 1.6% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | | 20,000 | | | | | | *1.0* | 0.8% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 22 | **3,500** | 77,000 | | 7,700 | 15,400 | 19,250 | 19,250 | 15,400 | | *3.9* | 3.0% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **137,000** | | | | | | | | ***6.9*** | **5.4%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | *1.0* | 0.8% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | *1.5* | 1.2% |
| 3 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | | 10,000 | | | | | | *0.5* | 0.4% |
| 4 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | | 20,000 | | | | | | *1.0* | 0.8% |
| 5 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 15 | **1,000** | 15,000 | | | 15,000 | | | | | *0.8* | 0.6% |
| 6 | *Shërbime gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 250 | **1,000** | 250,000 | | | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 100,000 | | *12.5* | 9.9% |
| 7 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 250 | **1,000** | 250,000 | | | | | 75,000 | 112,500 | 62,500 | *12.5* | 9.9% |
| 8 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | | | | | 12,000 | 18,000 | 10,000 | *2.0* | 1.6% |
| | Totali punimeve me krahë | | **635** | | **635,000** | | | | | | | | ***31.8*** | **25.1%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidaëe* | copë | 20,000 | **28** | 560,000 | | 560,000 | | | | | | *28.0* | 22.2% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 100 | **1,660** | 166,000 | 166,000 | | | | | | | *8.3* | 6.6% |
| 3 | *Plehëra inorganike baze NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | | 91,000 | | | | | | *4.6* | 3.6% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelem.* | kg | 550 | **280** | 154,000 | | 23,100 | 38,500 | 46,200 | 23,100 | 23,100 | | *7.7* | 6.1% |
| 5 | *Plehëra gjethore* | kg | 15 | **2,000** | 30,000 | | | | 3,000 | 9,000 | 12,000 | 6,000 | *1.5* | 1.2% |
| 6 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | | | *0.8* | 0.6% |
| 7 | *Fungicide* | kg | 28 | **6,000** | 168,000 | | 16,800 | 16,800 | 50,400 | 50,400 | 33,600 | | *8.4* | 6.6% |
| 8 | *Insekticide* | kg | 10 | **9,000** | 90,000 | | 9,000 | 9,000 | 27,000 | 27,000 | 18,000 | | *4.5* | 3.6% |
| 9 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **6** | 36,000 | 36,000 | | | | | | | *1.8* | 1.4% |
| 10 | *Spango për lidhje* | copë | 3 | **4,500** | 13,500 | | 13,500 | | | | | | *0.7* | 0.5% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **1,324,750** | | | | | | | | ***66.2*** | **52.4%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 2,400 | **14.0** | 33,600 | | 3,360 | 5,040 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 5,040 | *1.7* | 1.3% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 4,000 | **5** | 20,000 | | 2,000 | 3,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 3,000 | *1.0* | 0.8% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 10 | **2,500** | 25,000 | 7,500 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | 2,500 | | *1.3* | 1.0% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | *4.2* | 3.3% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | *0.7* | 0.6% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | | *1.5* | 1.2% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **206,600** | | | | | | | | ***10.3*** | **8.2%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serrës* | lekë | | | 200,000 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | *10.0* | 7.9% |
| 2 | *Sigurimet shoqerore* | lekë | | | 19,200 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | *1.0* | 0.8% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | *0.2* | 0.2% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **223,200** | | | | | | | | ***11.2*** | **8.8%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 2,303,350 | | | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 223,200 | | | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **2,526,550** | **445,636** | **818,096** | **194,376** | **248,206** | **318,106** | **383,706** | **118,426** | ***28.1*** | **100%** |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia I | | kg | 70,000 | **45** | 3,150,000 | | | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia II | | kg | 20,000 | **40** | 800,000 | | | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **3,950,000** | | | | | | | | | |
| ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | | ***1,423,450*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***28.1*** | | | | |
| ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | | ***57,567*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***43.9*** | | | | |
| ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | | ***141.73*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***36.0%*** | | | | |



# Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e dytë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Duke qënë produkti i dytë më e rëndësishëm i kultivuar në mjedise të mbrojtura pas domates, njohja e shpenzimeve dhe të ardhurave për këtë kulturë përbën rëndësi të veçantë për shumë aktorë, përfshi edhe vetë fermerët. Në këte seksion trajtohet struktura e kostove të prodhimit dhe të ardhurat për kultivimin e kastravecit në serra, kulturë e parë në skenarin e blerjes së imputeve me pakicë në sipërfaqe 1 hektar. Gjithashtu analizohet nevoja për kreditim, treguesit kryesorë ekonomikë, si edhe karakteristikat dhe potencialet e kastravecit në serra.

## Kostot e prodhimit

Kultivimi i kastravecit si kulturë e dytë në një sipërfaqe prej 1 ha duke përdorur impute me pakicë ka një kosto totale prej 1 941 150 lekë. Nga totali i kostove 1 717 950 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 223 000 lekë janë kosto fikse. Blerja e imputeve dhe materialeve zënë pjesën më të madhe në strukturën e kostove me 46.1%, ndjekur nga kostot e fuqisë punëtore me 31.2%. Njësoj si në rastin e domates, kostot fikse lidhen me amortizimin vjetor të serrës, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksën e tokës. Fakti që kostot fikse janë relativisht të ulëta, përbën një avantazh për fermat, pasi nuk kanë presionin e arritjes së rendimenteve sa më të larta dhe mund të fokusohen në arritjen e një cilësie maksimale.

### Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i kastravecit në serra gjeneron të ardhura relativisht të larta, si në ciklin e parë, edhe në ciklin e dytë të prodhimit duke e bërë kultivimin e saj atraktiv për shumë ferma në gjithë Shqipërinë. Kultivimi i kastravecit në serra, kulturë e dytë në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 80 ton dhe një të ardhur prej 3 460 00 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (60 ton), janë llogaritur me një çmim 45 lek/kg, ndërsa shitjet nga ciilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 38 lek/kg.

## Kreditimi

Në fillim të procesit të prodhimit të kastravecit në serra fermerët kanë nevojë për kreditim, kryesisht në formën e kapitalit qarkullues. Për sezonin e vjeshtës kapitali nevojitet kryesisht në muajin gusht, periudhë në të cilin fillon cikli i prodhimit për sezonin e dytë. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Për të ndihmuar në procesin e vendimarrjes dhe një arsyetim më të saktë mbi përfitueshmërinë ekonomike, përveç të ardhurave dhe shpenzimeve ka edhe tregues të tjerë të rëndësishëm, të cilët janë paraqitur më poshtë:

- **Fitimi neto:** 1 518 580 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 44 882 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 132.23 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 24.3 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 43.9%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkti i dytë më i rëndësishëm në grupin e perimeve në serra e në terma të prodhimit.
- Njohuri të mira dhe eksperiencë e gjatë në kultivim.
- Rajonet kryesore: Fier, Berat, Elbasan, Durrës, Shkodër; (burimi: AGIS).
- Mbështetje e madhe nga programet e granteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rritje e shpejtë e sipërfaqes së kultivuar.
- Marzhe të larta fitimi.
- Eksportet me rritje eksponenciale, (+11,000 ton në 5 vitet e fundit).
- Kërkesë e lartë në tregjet e zhvilluara të Perëndimit, por plotesimi i standarteve të larta, si Global Gap është domosdoshmëri.

**Paketa teknologjike për prodhimin e kastravecit në serrë - Kulturë e dytë - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë)**

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njesi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | | |
| | | | | | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **40,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | *2.0* | 2.1% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *1.0* | 1.0% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 18 | **3,500** | 63,000 | 6,300 | 6,300 | 15,750 | 18,900 | 15,750 | *3.2* | 3.2% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **123,000** | | | | | | ***6.2*** | **6.3%** |
| | | | | | ***Punime me krahë*** | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *1.0* | 1.0% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | | 10,000 | | | | *0.5* | 0.5% |
| 3 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | | 20,000 | | | | *1.0* | 1.0% |
| 4 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 15 | **1,000** | 15,000 | | | 15,000 | | | *0.8* | 0.8% |
| 5 | *Shërbime gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 250 | **1,000** | 250,000 | | | 50,000 | 100,000 | 100,000 | *12.5* | 12.9% |
| 6 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 250 | **1,000** | 250,000 | | | 50,000 | 100,000 | 100,000 | *12.5* | 12.9% |
| 7 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | | | 8,000 | 16,000 | 16,000 | *2.0* | 2.1% |
| | Totali punimeve me krahë | | **605** | | **605,000** | | | | | | ***30.3*** | **31.2%** |
| | | | | | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 20,000 | **18** | 360,000 | 360,000 | | | | | *18.0* | 18.5% |
| 2 | *Plehera inorganike baze NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | 91,000 | | | | | *4.6* | 4.7% |
| 3 | *Plehera kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 550 | **280** | 154,000 | | 30,800 | 46,200 | 46,200 | 30,800 | *7.7* | 7.9% |
| 4 | *Plehëra gjethore* | kg | 10 | **2,000** | 20,000 | | | 4,000 | 8,000 | 8,000 | *1.0* | 1.0% |
| 5 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | *0.8* | 0.8% |
| 6 | *Fungicide* | kg | 22 | **6,000** | 132,000 | | 13,200 | 39,600 | 39,600 | 39,600 | *6.6* | 6.8% |
| 7 | *Insekticide* | kg | 8 | **9,000** | 72,000 | | 14,400 | 14,400 | 21,600 | 21,600 | *3.6* | 3.7% |
| 8 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **6** | 36,000 | 36,000 | | | | | *1.8* | 1.9% |
| 9 | *Spango për lidhje* | copë | 3 | **4,500** | 13,500 | | 13,500 | | | | *0.7* | 0.7% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **894,750** | | | | | | ***44.7*** | **46.1%** |
| | | | | | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 1,800 | **14.0** | 25,200 | 7,560 | 7,560 | 3,780 | 3,780 | 2,520 | *1.3* | 1.3% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 3,000 | **5** | 15,000 | 4,500 | 4,500 | 2,250 | 2,250 | 1,500 | *0.8* | 0.8% |
| 3 | *Transport i inputeve ne fermë* | rrugë | 10 | **2,500** | 25,000 | 7,500 | 6,250 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | *1.3* | 1.3% |
| 4 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | *1.5* | 1.5% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **95,200** | | | | | | ***4.8*** | **4.9%** |
| | | | | | ***Kosto fikse*** | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serrës* | lekë | | | 200,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | *10.0* | 10.3% |
| 2 | *Sigurimet shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *1.0* | 1.0% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.2* | 0.2% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **223,200** | | | | | | ***11.2*** | **11.5%** |
| | Total i kostove variable (A+B+C+D) | lekë | | | 1,717,950 | | | | | | | |
| | Total i kostove fikse (E) | lekë | | | 223,200 | | | | | | | |
| | **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | lekë | | | **1,941,150** | **659,750** | **177,150** | **303,370** | **410,720** | **390,160** | ***24.3*** | **100%** |
| | Të ardhurat nga shitjet cilësia I | kg | 60,000 | **45** | 2,700,000 | | | | | | | |
| | Të ardhurat nga shitjet cilësia II | kg | 20,000 | **38** | 760,000 | | | | | | | |
| | **Të ardhurat totale** | lekë | | | **3,460,000** | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | **1,518,850** | | | | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | ***24.3*** | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***44,882*** | | | | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | ***43.3*** | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***132.23*** | | | | ***Marzhi i fitimit*** | ***43.9%*** | | |



# Karta teknologjike - Speca në serrë - Cikël i gjatë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Speci është kultura e tretë më e rëndësishme e kultivuar në mjedise të mbrojtura dhe konsumohet gjerësisht në tregun vendas. Duke qënë një produkt gjithnjë edhe më i kërkuar nga tregjet e eksportit, njohja e strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë kulturë përbën rëndësi të veçantë për investitorët e rinj, institucionet financiare, politikëbërësit dhe fermat bujqësore. Në këtë seksion shpjegohet karta teknologjike për prodhimin e specit në serra, cikël i gjatë në një sipërfaqe prej 1 hektar. Vlerat e paraqitura në tabelë janë shifra mesatare të konsultuara me ekspertë, ekstensionistë, fermerë dhe tregtarë të imputeve bujqësore.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera kostoja totale për kultivimin e 1 ha speca në serra, cikël i gjatë janë rreth 3 871 350 lekë. Nga totali i kostove 3 424 950 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 446 400 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve të nevojshme me 47.8% të totalit të kostove. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 29.4% e totalit të kostove të prodhimit. Megjithëse në rastin e specit, kostot fikse janë më të larta krahasuar me domaten dhe kastravecin, vlen të theksojmë se, gjithësesi ato mbetem të papërfillshme në strukturën e kostos totale.

### Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i specit në serra gjeneron të ardhura relativisht të larta, duke përbërë një aktivitet të rëndësishëm për shumë familje në zonat rurale. Kultivimi i specit në serra në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 100 ton dhe një të ardhur prej 6 800 000 lekë. Shitjet në dimër, (30 ton), janë llogaritur me një çmim 110 lek/kg, ndërsa shitjet në pranverë, (70 ton), me një çmim 50 lek/kg.

## Kreditimi

Periudha kur fermerët e kultivimit të specit në serra kanë nevojë për kreditim është muaji gusht, periudhë në të cilën fillon sezoni i prodhimit. Vjeljet fillojnë në nëntor dhe zgjasin deri në maj. Periudha më e përshtatshme për shlyerjen e kredisë është janar - maj. Një linjë kredie afatshkurtër, maksimumi 12 muaj me pagesa jo të rregullta është produkti i përshtatshëm për fermat që kultivojnë speca në serra, cikël i gjatë. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Treguesit e produktivitetit dhe performancës financiare janë shumë të rëndëishëm për të kuptuar leverdinë ekonomike të kultivimit të specit në serra. Pavarësisht se shifrat e të ardhurave dhe shpenzimeve japin informacion të rëndësishëm, analizimi i disa treguesve të rëndësishëm ofron një pasqyrë më të qartë:

- **Fitimi neto:** 2 928 650 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 56 932 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 87.72 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 38.7 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 43.1%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Një nga tre kulturat më të rëndësishme të kultivuara në , së bashku me domaten dhe kastravecin.
- Prodhimi në rritje të vazhdueshme nga viti në vit.
- Rajonet kryesore: Berat, Fier, Shkodër, Elbasan, Durrës, Tiranë; (burimi: AGIS).
- Mbështetje nga programet e granteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Fitimet e larta e shndërrojne në një aktivitet ekonomik të rëndësishëm për mijëra familje në zonat rurale.
- Pesëfishim i eksporteve në vitet e fundit, (5 397 ton - 3.4 mln USD - 2016).
- Kërkesë gjithnjë e më e lartë nga tregjet botërore, por plotesimi i standarteve të larta, si Global Gap është domosdoshmëri.

| Paketa teknologjike për prodhimin e specit në serre - Cikël i gjatë - Siperfaqja 1 ha (inpute me pakicë) | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njesi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
| | | | | | | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **40,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | | | | | | *0.6* | 1.0% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | | *0.3* | 0.5% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 25 | **3,500** | 87,500 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 17,500 | | *1.3* | 2.3% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **147,500** | | | | | | | | | | | ***2.1*** | **3.8%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | | *0.3* | 0.5% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | | | | *0.4* | 0.8% |
| 3 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | 10,000 | | | | | | | | | | *0.1* | 0.3% |
| 4 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | | *0.3* | 0.5% |
| 5 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 60 | **1,000** | 60,000 | | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | | | | | | *0.9* | 1.5% |
| 6 | *Shërbime gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 500 | **1,000** | 500,000 | | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | 50,000 | | *7.1* | 12.9% |
| 7 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 450 | **1,000** | 450,000 | | | | 45,000 | 67,500 | 67,500 | 67,500 | 67,500 | 67,500 | 67,500 | *6.4* | 11.6% |
| 8 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 50 | **1,000** | 50,000 | | | | 5,000 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | *0.7* | 1.3% |
| | Totali punimeve me krahë | | **1,140** | | **1,140,000** | | | | | | | | | | | ***16.3*** | **29.4%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 25,000 | **28** | 700,000 | 700,000 | | | | | | | | | | *10.0* | 18.1% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | kg | 100 | **1,660** | 166,000 | 166,000 | | | | | | | | | | *2.4* | 4.3% |
| 3 | *Plehëra inorganike baze NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | 91,000 | | | | | | | | | | *1.3* | 2.4% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 1,000 | **280** | 280,000 | | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 28,000 | | | *4.0* | 7.2% |
| 5 | *Plehera gjethore* | kg | 25 | **2,000** | 50,000 | | | | 5,000 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | *0.7* | 1.3% |
| 6 | *PMB kunder demtuesve te tokes* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | | | | | | *0.2* | 0.4% |
| 7 | *Fungicide* | kg | 30 | **6,000** | 180,000 | | 18,000 | 18,000 | 18,000 | 27,000 | 27,000 | 27,000 | 27,000 | 18,000 | | *2.6* | 4.6% |
| 8 | *Insekticide* | kg | 12 | **9,000** | 108,000 | | 10,800 | 10,800 | 10,800 | 16,200 | 16,200 | 16,200 | 16,200 | 10,800 | | *1.5* | 2.8% |
| 9 | *Blete pjalmuese* | koshere | 12 | **15,000** | 180,000 | | | | 90,000 | | | 90,000 | | | | *2.6* | 4.6% |
| 10 | *Plasmas per mulcerim* | m2 | 6,000 | **6** | 36,000 | 36,000 | | | | | | | | | | *0.5* | 0.9% |
| 11 | *Spango per lidhje* | copë | 10 | **4,500** | 45,000 | | 11,250 | 11,250 | 11,250 | 11,250 | | | | | | *0.6* | 1.2% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **1,852,250** | | | | | | | | | | | ***26.5*** | **47.8%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 4,800 | **14.0** | 67,200 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | *1.0* | 1.7% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 8,000 | **5** | 40,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | *0.6* | 1.0% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 20 | **2,500** | 50,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | *0.7* | 1.3% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | | | | *1.2* | 2.2% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | | | | *0.2* | 0.4% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | *0.4* | 0.8% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **285,200** | | | | | | | | | | | ***4.1*** | **7.4%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serres* | lekë | | | 400,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | *5.7* | 10.3% |
| 2 | *Sigurimet shoqerore* | lekë | | | 38,400 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *0.5* | 1.0% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 8,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.1* | 0.2% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **446,400** | | | | | | | | | | | ***6.4*** | **11.5%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 3,424,950 | | | | | | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 446,400 | | | | | | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **3,871,350** | **1,319,360** | **219,160** | **219,160** | **364,160** | **341,060** | **314,810** | **404,810** | **300,810** | **242,160** | **145,860** | ***38.7*** | **100%** |
| Të ardhurat nga shitjet në dimër | | kg | 30,000 | **110** | 3,300,000 | | | | | | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet në pranverë | | kg | 70,000 | **50** | 3,500,000 | | | | | | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **6,800,000** | | | | | | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | ***2,928,650*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***38.7*** | | | | | | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***56,932*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***68.0*** | | | | | | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***87.72*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***43.1%*** | | | | | | | |



# Karta teknologjike - Patëllxhan në serrë - Cikël i gjatë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Patëllxhani është një tjetër kulturë e rëndësishme në grupin e perimeve. Patëllxhani është një produkt me vlera të larta ushqyese dhe mbillet gjerësisht në Shqipëri duke qënë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje. Në këtë seksion shpjegohet struktura e shpenzimeve dhe të ardhurave për kultivimin e patëllxhanit në serra, cikël i gjatë në rastin e blerjes së imputeve me pakicë. Vlerat e paraqitura në tabelë janë shifra mesatare të konsultuara me ekspertë, ekstensionistë, fermerë dhe tregtarë të imputeve bujqësore.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera kostoja totale për kultivimin e 1 ha patëllxhan në serra, cikël i gjatë janë rreth 3 451 350 lekë. Nga totali i kostove 3 004 950 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 446 400 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve të nevojshme me 41.5% të totalit të kostove. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 33.0% e totalit të kostove të prodhimit.

Kostot fikse në terma relative janë më të larta se në rastin e specave, gjithashtu fuqia punëtore përbën një peshë më të lartë në strukturën e kostove totale krahasuar me kulturat e tjera.

### Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i patëllxhanit në serra gjeneron të ardhura të mira, duke qënë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje në zonat rurale. Kultivimi i patëllxhanit në serra, cikël i gjatë në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 100 ton dhe një të ardhur prej 6 500 000 lekë. Shitjet në dimër, (30 ton), janë llogaritur me një çmim 100 lek/kg, ndërsa shitjet në pranverë, (70 ton), me një çmim 50 lek/kg.

## Kreditimi

Periudha kur fermerët e kultivimit të patëllxhanit në serra kanë nevojë për kreditim është muaji shtator, periudhë në të cilën fillon sezoni i prodhimit. Vjeljet fillojnë në nëntor dhe zgjasin deri në qershor. Periudha më e përshtatshme për shlyerjen e kredisë është shkurt -qershor, periudhë në të cilën prodhimi dhe shitjet arrijnë kulmin. Një linjë kredie afatshkurtër maksimumi 12 muaj me pagesa jo të rregullta është produkti i përshtatshëm. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Përveç shpenzimeve dhe të ardhurave disa tregues të tjerë janë shumë rëndësishëm. P.sh., rendimenti në pikën kritike sinjalizon fermerët, në mënyrë që të evitojnë humbjet duhet të prodhojnë të paktën 53 ton/ha, çdo rendiment më i ulët duke pasur parasysh çmimin mesatar do të rezultonte në humbje.

- **Fitimi neto:** 3 048 650 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 53 098 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 87.72 kg/ditë pune
- **Kostoja e prodhimit:** 34.5 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 46.9%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Vlera të larta ushqimore.
- Trend pozitiv i prodhimit.
- Rajonet kryesore: Fier, Berat, Shkodër; (burimi: AGIS).
- Përmirësim i njohurive dhe teknologjive të kultivimit.
- Marzhe të larta fitimi.
- Importet vazhdojnë të jenë më të larta se eksportet.
- Burim të ardhurash për familjet rurale.
- Trend pozitiv i prodhimit organik.

## Paketa teknologjike për prodhimin e patellxhanit në serrë - Cikël i gjatë - Siperfaqja 1 ha (inpute me pakicë)

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **40,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | | | | | | *0.4* | 1.2% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | | *0.2* | 0.6% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 25 | **3,500** | 87,500 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 8,750 | 17,500 | | *0.9* | 2.5% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **147,500** | | | | | | | | | | | ***1.5*** | **4.3%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | | *0.2* | 0.6% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | | | | *0.3* | 0.9% |
| 3 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | 10,000 | | | | | | | | | | *0.1* | 0.3% |
| 4 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | | *0.2* | 0.6% |
| 5 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 60 | **1,000** | 60,000 | | 15,000 | 15,000 | 15,000 | 15,000 | | | | | | *0.6* | 1.7% |
| 6 | *Shërbime gjate vegjetacionit* | ditë pune | 500 | **1,000** | 500,000 | | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | 50,000 | | *5.0* | 14.5% |
| 7 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 450 | **1,000** | 450,000 | | | 45,000 | 45,000 | 45,000 | 67,500 | 67,500 | 67,500 | 67,500 | 45,000 | *4.5* | 13.0% |
| 8 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 50 | **1,000** | 50,000 | | | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 5,000 | *0.5* | 1.4% |
| | Totali punimeve me krahe | | **1,140** | | **1,140,000** | | | | | | | | | | | ***11.4*** | **33.0%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 10,000 | **28** | 280,000 | 280,000 | | | | | | | | | | *2.8* | 8.1% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 100 | **1,660** | 166,000 | 166,000 | | | | | | | | | | *1.7* | 4.8% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | 91,000 | | | | | | | | | | *0.9* | 2.6% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 1,000 | **280** | 280,000 | | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 42,000 | 28,000 | | | *2.8* | 8.1% |
| 5 | *Plehëra gjethore* | kg | 25 | **2,000** | 50,000 | | | | 5,000 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | 7,500 | *0.5* | 1.4% |
| 6 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | | | | | | *0.2* | 0.5% |
| 7 | *Fungicide* | kg | 30 | **6,000** | 180,000 | | 18,000 | 18,000 | 18,000 | 27,000 | 27,000 | 27,000 | 27,000 | 18,000 | | *1.8* | 5.2% |
| 8 | *Insekticide* | kg | 12 | **9,000** | 108,000 | | 10,800 | 10,800 | 10,800 | 16,200 | 16,200 | 16,200 | 16,200 | 10,800 | | *1.1* | 3.1% |
| 9 | *Bletë pjalmuese* | koshere | 12 | **15,000** | 180,000 | | | | 90,000 | | | 90,000 | | | | *1.8* | 5.2% |
| 10 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **6** | 36,000 | 36,000 | | | | | | | | | | *0.4* | 1.0% |
| 11 | *Spango për lidhje* | copë | 10 | **4,500** | 45,000 | | 11,250 | 11,250 | 11,250 | 11,250 | | | | | | *0.5* | 1.3% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **1,432,250** | | | | | | | | | | | ***14.3*** | **41.5%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 4,800 | **14.0** | 67,200 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | *0.7* | 1.9% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 8,000 | **5** | 40,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | *0.4* | 1.2% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 20 | **2,500** | 50,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | *0.5* | 1.4% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | | | | *0.8* | 2.4% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | | | | *0.1* | 0.4% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | *0.3* | 0.9% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **285,200** | | | | | | | | | | | ***2.9*** | **8.3%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serrës* | lekë | | | 400,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | *4.0* | 11.6% |
| 2 | *Sigurimet shoqerore* | lekë | | | 38,400 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *0.4* | 1.1% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 8,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.1* | 0.2% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **446,400** | | | | | | | | | | | ***4.5*** | **12.9%** |
| | Total i kostove variable (A+B+C+D) | lekë | | | 3,004,950 | | | | | | | | | | | | |
| | Total i kostove fikse (E) | lekë | | | 446,400 | | | | | | | | | | | | |
| | **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | lekë | | | **3,451,350** | **899,360** | **219,160** | **269,160** | **364,160** | **316,060** | **314,810** | **404,810** | **300,810** | **242,160** | **120,860** | ***115.0*** | 100% |
| | Të ardhurat nga shitjet në dimër | kg | 30,000 | **100** | 3,000,000 | | | | | | | | | | | | |
| | Të ardhurat nga shitjet në pranverë | kg | 70,000 | **50** | 3,500,000 | | | | | | | | | | | | |
| | **Të ardhurat totale** | lekë | | | **6,500,000** | | | | | | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | **3,048,650** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***34.5*** | | | | | | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***53,098*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***65.0*** | | | | | | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***87.72*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***46.9%*** | | | | | | | |



# Karta teknologjike - Kungulleshka në serrë - Cikël i gjatë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Kungulleshkat janë një produkt i rëndësishëm në grupin e perimeve dhe po kultivohen gjithnjë e më shumë në mjedisee të mbrojtura. Njohja e strukturës së kostove dhe të ardhurave përbën një rëndësi të veçantë për investitorët e rinj, si edhe institucionet financiare të cilat kanë një rol të rëndësishëm me anë të kreditimit. Në këtë seksion do të analizohet struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve për kultivimin e kungulleshkës në serra. Përveç të ardhurave dhe shpenzimeve një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet disa prej treguesve kryesorë si: marzhi i fitimit, rendimentet dhe produktiviteti i punës, kosto për njësi, etj.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera kosto totale për kultivimin e 1 ha kungulleshka në serra, cikël i gjatë në skenarin e blerjes së imputeve me pakicë janë rreth 2 156 150 lekë. Nga totali i kostove 1 932 950 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 223 200 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve me 47.7% të totalit. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 31.5% e totalit të kostove të prodhimit.

Kostot fikse zënë rreth 10.4% të totalit të kostove të prodhimit. Kosto të tjera të prodhimit janë kostot e punimeve të mekanizuara: plugime, frezime, të cilat kryhen në fillim të sezonit të prodhimit, si edhe shpenzime të tjera, si ujë, energji elektrike, transport, etj.

**Struktura e kostove**




## Të ardhurat

Kultivimi i kungulleshkave në serra gjeneron të ardhura të mira duke qenë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje në zonat rurale. Kultivimi i kungulleshkës në serra, cikël i gjatë në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 100 ton dhe një të ardhur prej 3 825 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (55 ton), janë llogaritur më një çmim 55 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 40 lek/kg.

## Kreditimi

Periudha kur fermerët e kultivimit të kungulleshkës në serra kanë nevojë për kreditim është muaji tetor, periudhë në të cilën fillon sezoni i prodhimit për ciklin e dimrit. Produkti vilet dhe shitet në periudhën janar - shkurt. Periudha më e përshtatshme për shlyerjen e kredisë është pikërisht periudha e vjeljes dhe shitjes së produktit në muajt janar dhe shkurt. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku kohor i kreditimit**




## Treguesit kryesorë

Përveç shpenzimeve dhe të ardhurave, tregues të tjerë janë të rëndësishëm. P.sh.: kostoja e prodhimit, e cila luan një faktor të rëndësishëm në vendosjen e çmimit të shitjes. Kostoja e prodhimit prej 28.7 lek/kg i sinjalizon fermerët se, nëse shesin me çmim më të ulët së 28.7 lek/kg duke pasur parasysh rendimentin e arritur, do të rezultojnë me humbje.

- **Fitimi neto:** 1 668 850 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 42 277 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 110.29 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 28.7 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 43.6%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkt i përshtatshëm për gatime të ndryshme.
- Shtim i sipërfaqeve të kultivuara.
- Rajonet kryesore: Fier, Elbasan, Berat; (burimi: AGIS).
- Përmirësim i njohurive dhe teknologjive të kultivimit.
- Marzhe të larta fitimi.
- Importet vazhdojnë të konkurojnë prodhimin vendas.
- Burim i rëndësishëm të ardhurash.
- Eksporte relativisht të uléta, për shkak se ka shumë pak ferma të specializuara vetëm në prodhimin e kungulleshkave, zakonisht prodhohet nga fermat mikse.

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **40,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | *0.5* | 1.9% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 0.9% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 16 | **3,500** | 56,000 | 8,400 | 14,000 | 19,600 | 14,000 | | *0.7* | 2.6% |
| | Totali mekanikes bujqësore | | | | **116,000** | | | | | | ***1.5*** | **5.4%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 0.9% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | 10,000 | | | | | *0.1* | 0.5% |
| 3 | *Mbjellje e fidaneve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 0.9% |
| 4 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | | 15,000 | 15,000 | | | *0.4* | 1.4% |
| 5 | *Shërbime gjate vegjetacionit* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | 28,000 | 84,000 | 84,000 | 84,000 | | *3.7* | 13.0% |
| 6 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | | | 56,000 | 112,000 | 112,000 | *3.7* | 13.0% |
| 7 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | | | 8,000 | 16,000 | 16,000 | *0.5* | 1.9% |
| | Totali punimeve me krahë | | **680** | | **680,000** | | | | | | ***9.1*** | **31.5%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 10,000 | **28** | 280,000 | 280,000 | | | | | *3.7* | 13.0% |
| 2 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | 91,000 | | | | | *1.2* | 4.2% |
| 3 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 1,000 | **280** | 280,000 | 42,000 | 70,000 | 98,000 | 70,000 | | *3.7* | 13.0% |
| 4 | *Plehëra gjethore* | kg | 10 | **2,000** | 20,000 | | | 6,000 | 8,000 | 6,000 | *0.3* | 0.9% |
| 5 | *PMB kundër demtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | *0.2* | 0.8% |
| 6 | *Fungicide* | kg | 20 | **6,000** | 120,000 | 18,000 | 30,000 | 42,000 | 30,000 | | *1.6* | 5.6% |
| 7 | *Insekticide* | kg | 8 | **9,000** | 72,000 | 10,800 | 18,000 | 25,200 | 18,000 | | *1.0* | 3.3% |
| 8 | *Bletë pjalmuese* | koshere | 6 | **15,000** | 90,000 | | | 90,000 | | | *1.2* | 4.2% |
| 9 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **6** | 36,000 | 36,000 | | | | | *0.5* | 1.7% |
| 10 | *Spango për lidhje* | copë | 5 | **4,500** | 22,500 | | 11,250 | 11,250 | | | *0.3* | 1.0% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **1,027,750** | | | | | | ***13.7*** | **47.7%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 1,800 | **14.0** | 25,200 | 5,040 | 5,040 | 5,040 | 5,040 | 5,040 | *0.3* | 1.2% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 3,000 | **5** | 15,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | *0.2* | 0.7% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 10 | **2,500** | 25,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | *0.3* | 1.2% |
| 4 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | *0.2* | 0.6% |
| 5 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | *0.4* | 1.4% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **109,200** | | | | | | ***1.5*** | **5.1%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serrës* | lekë | | | 200,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | *2.7* | 9.3% |
| 2 | *Sigurimet shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *0.3* | 0.9% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.1* | 0.2% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **223,200** | | | | | | ***3.0*** | **10.4%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 1,932,950 | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 223,200 | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **2,156,150** | **718,130** | **305,930** | **518,730** | **415,680** | **197,680** | ***39.2*** | **100%** |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia I | | kg | 55,000 | **55** | 3,025,000 | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia II | | kg | 20,000 | **40** | 800,000 | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **3,825,000** | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | ***1,668,850*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***28.7*** | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***42,277*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***51.0*** | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***110.29*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***43.6%*** | | |

Paketa teknologjike për prodhimin e kungulleshkave - Cikël i dimrit - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë)



# Karta teknologjike - Luleshtrydhe në serrë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Luleshtrydhja është një frut që ka filluar të shihet me prioritet sidomos në 4 - 5 vitet e fundit. Shumë fermerë kanë ngurruar të kultivojnë luleshtrydhen në serra për shkak të kostove relativisht të larta fillestare, por duke parë fitimet e larta që mund të arrihen nga ky produkt interesi po rritet çdo ditë e më shumë. Njohja e strukturës së kostove dhe të ardhura, si edhe disa prej treguesve kryesorë në lidhje me kultivimin e luleshtrydhes në serra përbën një rëndësi të veçantë për investitorët e rinj, si edhe institucionet financiare të cilat kanë një rol të rëndësishëm me anë të kreditimit.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera në konsultim me ekspertë dhe aktorë të ndryshëm, kostoja totale për kultivimin e 1 ha luleshtrydhe në serra është rreth 6 010 850 lekë. Nga totali i kostove 5 564 450 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 446 400 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së Imputeve me 64.7% të totalit. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 21.6% e totalit të kostove të prodhimit.

Pra, blerja e Imputeve dhe materialeve së bashku me fuqinë punëtore përbëjnë më shumë se 3/4 të totalit të kostove. Kostot fikse janë 7.4% e totalit të kostove dhe pjesa e mbetur janë punime të mekanizuara dhe shpenzime të tjera.

### Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i luleshtrydhes në serra te ulëta gjeneron të ardhura të kënaqshme, duke rritur gjithnjë e me shumë interesin e investitorëve për kultivimin e këtij produkti. Kultivimi i luleshtrydhes në serra, në skenarin e Imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 55 ton dhe një të ardhur prej 9 150 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (40 ton), janë llogaritur me një çmim 180 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e dytë, (15 ton), me një çmim 130 lek/kg.

## Kreditimi

Luleshtrydhja në serra ka kosto relativisht të larta në fillim të sezonit të prodhimit. Kreditimi nevojitet kryesisht në muajin tetor, periudhë në të cilën fillon sezoni i prodhimit. Vjeljet fillojnë në janar dhe zgjasin deri në qershor. Një linjë kredie afatshkurtër me pagesa jo të rregullta është produkti i përshtatshëm bankar. Periudha më e përshtatshme për shlyerjen e kredisë është mars - qershor, periudhë në të cilën prodhimi dhe shitjet arrijnë kulmin.

### Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Përveç shpenzimeve dhe të ardhurave, tregues të tjerë janë të rëndësishëm. P.sh.: kostoja e prodhimit, e cila luan një rol të rëndësishëm në vendosjen e çmimit të shitjes. Kostoja e prodhimit prej 109.3 lek/kg i sinjalizon fermerët se, nëse shesin me çmim më të ulët se 109.3 lek/kg, duke pasur parasysh rendimentin e arritur, do të rezultojnë me humbje.

- **Fitimi neto:** 3 139 8150 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 36 131 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 42.31 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 109.3 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 34.3%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Preferencë e lartë e konsumatorëve për produktin vendas.
- Rritje e shpejtë e sipërfaqeve të kultivuara dhe prodhimit.
- Rajonet kryesore: Fier + 90%, Durrës; (burimi: AGIS).
- Interes i lartë për investime të reja.
- Marzhe të larta fitimi.
- Burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje.
- Kërkesa nga tregjet perëndimore në rritje të vazhdueshme.
- Rritje eksponenciale e eksporteve, (dhjetëfishim në pesë vitet e fundit; eksportet në vitin 2016 ishin 982 ton ose rreth 1 milion Euro).

**Paketa teknologjike për prodhimin e luleshtrydhes - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë)**

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | *1.3* | 0.3% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | *1.3* | 0.3% |
| 3 | *Përgatitja e vllajave* | ha | 1 | **50,000** | 50,000 | 50,000 | | | | | | | | | *3.3* | 0.8% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **90,000** | | | | | | | | | | ***6.0*** | **1.5%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Shpendarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | | | *2.0* | 0.5% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 7 | **1,000** | 7,000 | 7,000 | | | | | | | | | *0.5* | 0.1% |
| 3 | *Ngritja e tuneleve, shtrimi i plasmasit të mulçerimit dhe shtrirja e sistemit të ujitjes* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | *1.3* | 0.3% |
| 4 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | | | | | *2.7* | 0.7% |
| 5 | *Spërkatje me pompë shpine* | ditë pune | 43 | **1,000** | 43,000 | 4,300 | 4,300 | 4,300 | 6,450 | 6,450 | 6,450 | 6,450 | 4,300 | | *2.9* | 0.7% |
| 6 | *Sherbime gjatë vegjetacionit (këputja e luleve, heqja e stoloneve dhe gjetheve të vjetra)* | ditë pune | 500 | **1,000** | 500,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | | *33.3* | 8.3% |
| 7 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 600 | **1,000** | 600,000 | | | | 30,000 | 48,000 | 90,000 | 150,000 | 180,000 | 102,000 | *40.0* | 10.0% |
| 8 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 60 | **1,000** | 60,000 | | | | 3,000 | 4,800 | 9,000 | 15,000 | 18,000 | 10,200 | *4.0* | 1.0% |
| | Totali punimeve me krahë | | **1,300** | | **1,300,000** | | | | | | | | | | ***86.7*** | **21.6%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 75,000 | **24** | 1,800,000 | 1,800,000 | | | | | | | | | *120.0* | 29.9% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 100 | **1,660** | 166,000 | 166,000 | | | | | | | | | *11.1* | 2.8% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **130** | 91,000 | 91,000 | | | | | | | | | *6.1* | 1.5% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 1,400 | **280** | 392,000 | | 58,800 | 58,800 | 58,800 | 58,800 | 58,800 | 58,800 | 39,200 | | *26.1* | 6.5% |
| 5 | *Plehëra gjethore* | kg | 25 | **2,000** | 50,000 | | | | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | 10,000 | | *3.3* | 0.8% |
| 6 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | | | | | *1.1* | 0.3% |
| 7 | *Fungicide* | kg | 40 | **6,000** | 240,000 | | 24,000 | 24,000 | 24,000 | 36,000 | 48,000 | 48,000 | 36,000 | | *16.0* | 4.0% |
| 8 | *Insekticide* | kg | 12 | **9,000** | 108,000 | | 10,800 | 10,800 | 10,800 | 16,200 | 21,600 | 21,600 | 16,200 | | *7.2* | 1.8% |
| 9 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **6** | 36,000 | 36,000 | | | | | | | | | *2.4* | 0.6% |
| 10 | *Arka ambalazhi* | copë | 9,000 | **50** | 450,000 | | | | 22,500 | 36,000 | 67,500 | 112,500 | 135,000 | 76,500 | *30.0* | 7.5% |
| 11 | *Kupa (9 copëshe)* | copë | 9,000 | **60** | 540,000 | | | | 27,000 | 43,200 | 81,000 | 135,000 | 162,000 | 91,800 | *36.0* | 9.0% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **3,889,250** | | | | | | | | | | ***259.3*** | **64.7%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 4,800 | **14.0** | 67,200 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 13,440 | 6,720 | *4.5* | 1.1% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 8,000 | **5** | 40,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 8,000 | 4,000 | *2.7* | 0.7% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rruge | 20 | **2,500** | 50,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 7,500 | 7,500 | 5,000 | *3.3* | 0.8% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | | | *5.6* | 1.4% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | | | *0.9* | 0.2% |
| 6 | *Të paparishikuara* | leke | 1 | **30,000** | 30,000 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,600 | *2.0* | 0.5% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **285,200** | | | | | | | | | | ***19.0*** | **4.7%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e tuneleve* | lekë | | | 400,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 48,000 | *26.7* | 6.7% |
| 2 | *Sigurimet shoqërore* | lekë | | | 38,400 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,608 | *2.6* | 0.6% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 8,000 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 960 | *0.5* | 0.1% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **446,400** | | | | | | | | | | ***29.8*** | **7.4%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 5,564,450 | | | | | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 446,400 | | | | | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **6,010,850** | **2,516,674** | **216,024** | **216,024** | **310,674** | **402,574** | **535,474** | **702,974** | **757,044** | **353,388** | ***109.3*** | 100% |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia e parë | | kg | 40,000 | **180** | 7,200,000 | | | | | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia e dytë | | kg | 15,000 | **130** | 1,950,000 | | | | | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **9,150,000** | | | | | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | **3,139,150** | | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | ***109.3*** | | | | | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***36,131*** | | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | ***166.4*** | | | | | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***42.31*** | | ***Marzhi i fitimit*** | | | ***34.3%*** | | | | | | |

Shënime:

# KARTAT TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMEVE NË SERRA INPUTE ME SHUMICË



# Karta teknologjike - Domate serre - Kulturë e parë - Impute me shumicë - Sipërfaqe 1 ha

Në këtë seksion analizohet struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe treguesit e tjerë kryesorë në lidhje me kultivimin e domates në serra, si kulturë e parë në rastin e blerjes së imputeve me shumicë në një sipërfaqe 1 hektar. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar përcaktimit të nevojave në lidhje me kreditimin, si p.sh. lloji i kreditimit, periudha kur nevojitet, etj. Në rastin e imputeve me shumicë kostot janë më të ulëta dhe marzhi i fitimit më i lartë, duke sinjalizuar fermerët mbi rëndësinë e bashkëpunimit.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera kostoja totale për kultivimin e 1 ha domate në serra, kulturë e parë në rastin e blejres së imputeve me shumicë janë rreth 2 580 350 lekë. Nga totali i kostove 2 357 150 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 223 000 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve të nevojshme me 50.8% të totalit të kostove. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 27.9% e totalit të kostove të prodhimit. Kostot fikse lidhen me amortizimin vjetor të serrës, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksën e tokës. Arritja e një rendimenti sa më të lartë, sigurisht duke ruajtur cilësinë e duhur do të reduktonte kostot fikse duke rritur kështu të ardhurat dhe fitimin. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet struktura e plotë e kostove të prodhimit.

**Struktura e kostove**




## Të ardhurat

Kultivimi i domates në serra gjeneron të ardhura relativisht të larta, duke tërhequr gjithnjë e më shumë investime në këtë sektor. Kultivimi i domates në serra, kulturë e parë në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 100 ton dhe një të ardhur prej 4 300 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (80 ton), janë llogaritur me një çmim 45 lek/kg, ndërsa shitjet nga ciilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 35 lek/kg.

## Kreditimi

Kreditimi nga institucionet financiare është shumë i rëndësishëm për fermat në fazën e nisjes së procesit të prodhimit. Kreditimi në formën e kapitalit qarkullues nevojitet në muajin dhjetor, muaj në të cilin fillon edhe sezoni i prodhimit. Fermerët mund të nisin të shlyejnë kredinë duke filluar nga muaji prill, muaj në të cilin fillojnë të arkëtojnë nga shitjet. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku kohor i kreditimit**




## Treguesit kryesorë

Nëpërmjet treguesve në këtë seksion do të arrijmë të kuptojmë edhe diferencat pozitive midis blerjeve të imputeve me shumicë dhe pakicë. P.sh.: marzhi i fitimit është rreth 5% më i lartë, sasia në pikën kritike është më e ulët duke zbutur disi presionin për rendimente sa më të larta. Fitimi neto ≈ + 200 000 lekë më i lartë.

- **Fitimi neto:** 1 719 650 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 60 008 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 138.89 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 25.8 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 40.0%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkti më i rëndësishëm në grupin e perimeve në terma të prodhimit dhe konsumit.
- Traditë e vjetër në kultivim.
- Rajonet kryesore: Fier, Berat, Elbasan, Shkodër, Durrës; (burimi: AGIS).
- Mbështetje e madhe nga programet e granteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rritje e shpejtë e sipërfaqes me domate në serra.
- Interes i lartë për investime nxitur nga marzhet e larta të fitimit.
- Produkti më i eksportuar në grupin e fruta – perimeve, (63 700 ton - 24.6 mln USD).
- Kërkesë gjithnjë e më e lartë nga tregjet botërore, por plotesimi i standarteve të larta, si Global Gap është domosdoshmëri.

**Paketa teknologjike për prodhimin e domates në serrë - Kulturë e pare - Sipërfaqja 1 ha (inpute me shumicë)**

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **35,000** | 35,000 | 35,000 | | | | | | | *0.4* | 1.4% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | | 20,000 | | | | | | *0.2* | 0.8% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 20 | **3,200** | 64,000 | | 6,400 | 12,800 | 16,000 | 16,000 | 12,800 | | *0.6* | 2.5% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **119,000** | | | | | | | | ***1.2*** | **4.6%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | *0.2* | 0.8% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | *0.3* | 1.2% |
| 3 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | | 10,000 | | | | | | *0.1* | 0.4% |
| 4 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | | 20,000 | | | | | | *0.2* | 0.8% |
| 5 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | | 15,000 | 15,000 | | | | | *0.3* | 1.2% |
| 6 | *Shërbime gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | | | 56,000 | 56,000 | 56,000 | 112,000 | | *2.8* | 10.9% |
| 7 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | | | | | 84,000 | 126,000 | 70,000 | *2.8* | 10.9% |
| 8 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 50 | **1,000** | 50,000 | | | | | 15,000 | 22,500 | 12,500 | *0.5* | 1.9% |
| | Totali punimeve me krahë | | **720** | | **720,000** | | | | | | | | ***7.2*** | **27.9%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 25,000 | **23** | 575,000 | | 575,000 | | | | | | *5.8* | 22.3% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 100 | **1,500** | 150,000 | 150,000 | | | | | | | *1.5* | 5.8% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **110** | 77,000 | | 77,000 | | | | | | *0.8* | 3.0% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 600 | **230** | 138,000 | | 20,700 | 34,500 | 41,400 | 20,700 | 20,700 | | *1.4* | 5.3% |
| 5 | *Plehëra gjethore* | kg | 15 | **1,670** | 25,050 | | | | 2,505 | 7,515 | 10,020 | 5,010 | *0.3* | 1.0% |
| 6 | *PMB kunder dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **540** | 13,500 | 13,500 | | | | | | | *0.1* | 0.5% |
| 7 | *Fungicide* | kg | 25 | **5,000** | 125,000 | | 12,500 | 12,500 | 37,500 | 37,500 | 25,000 | | *1.3* | 4.8% |
| 8 | *Insekticide* | kg | 10 | **8,000** | 80,000 | | 8,000 | 8,000 | 24,000 | 24,000 | 16,000 | | *0.8* | 3.1% |
| 9 | *Bletë pjalmuese* | koshere | 6 | **13,000** | 78,000 | | | | 78,000 | | | | *0.8* | 3.0% |
| 10 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **5** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | *0.3* | 1.2% |
| 11 | *Spango për lidhje* | copë | 5 | **4,000** | 20,000 | | 10,000 | 10,000 | | | | | *0.2* | 0.8% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **1,311,550** | | | | | | | | ***13.1*** | **50.8%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 2,400 | **14.0** | 33,600 | | 3,360 | 5,040 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 5,040 | *0.3* | 1.3% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 4,000 | **5** | 20,000 | | 2,000 | 3,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 3,000 | *0.2* | 0.8% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 10 | **2,500** | 25,000 | | 5,000 | 5,000 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | 3,750 | *0.3* | 1.0% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | *0.8* | 3.3% |
| 5 | *Analiza e tokeës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | *0.1* | 0.5% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | | *0.3* | 1.2% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **206,600** | | | | | | | | ***2.1*** | **8.0%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serës* | lekë | | | 200,000 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | 28,571 | *2.0* | 7.8% |
| 2 | *Sigurimet shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | 2,743 | *0.2* | 0.7% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | 571 | *0.0* | 0.2% |
# Karta teknologjike - Kungulleshka në serrë - Cikël i gjatë - Impute me shumicë - Sipërfaqe 1 ha

Kungulleshkat janë një produkt i rëndësishëm në grupin e perimeve dhe po kultivohet gjithnjë e më shumë në mjedise të mbrojtura. Njohja e strukturës së kostove dhe të ardhurave përbën një rëndësi të veçantë për investitorët e rinj, si edhe institucionet , të cilat kanë një rol të rëndësishëm me anë të kreditimit. Në këtë seksion analizohet struktura e shpenzimeve dhe të ardhurave për kultivimin e kungulleshkës në serra, cikël i gjatë në rastin e blerjes së imputeve me shumicë.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera kostoja totale për kultivimin e 1 ha kungulleshka në serra, cikël i gjatë në skenarin e blerjes së imputeve me shumicë janë rreth 1 987 800 lekë. Nga totali i kostove 1 764 600 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 223 200 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve me 43.7% të totalit. Kostoja e dytë më e rëndësishme është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 34.2% e totalit të kostove të prodhimit.
Kostoja e punimeve me krahë, ka një peshë më të madhe në strukturën totale të kostove, si pasojë e rëniës së kostove të blerjes së imputeve në rastin e blerjes me shumicë.

### Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i kungulleshkave në serra gjeneron të ardhura të mira, duke qënë një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje në zonat rurale. Kultivimi i kungulleshkave në serra, cikël i gjatë në skenarin e imputeve me shumicë gjeneron një nivel prodhimi prej 100 ton dhe një të ardhur prej 3 825 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (55 ton, janë llogaritur më një çmim 55 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 40 lek/kg.

## Kreditimi

Periudha kur fermerët e kultivimit të kungulleshkës në serra kanë nevojë për kreditim është muaji tetor, periudhë në të cilën fillon sezoni i prodhimit për ciklin e dimrit. Produkti vilet dhe shitet në periudhën janar - shkurt. Periudha më e përshtatshme për shlyerjen e kredisë është pikërisht, periudha e vjeljes dhe shitjes së produktit në muajt janar dhe shkurt.

### Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Ashtu si për pjesën më të madhe të produkteve të analizuara, edhe në rastin e kungulleshkës, blerja e imputeve me shumicë ndikon në rritjen e fitimit, reduktimin e kostos së prodhimit për njësi dhe redukton sasinë e prodhimit të nevojshme për të shmangur humbjen.

- **Fitimi neto:** 1 837 200 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 38 976 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 110.29 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 26.5 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 48.0%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkt i përshtatshëm për gatime të ndryshme.
- Shtim i sipërfaqeve të kultivuara.
- Rajonet kryesore: Fier, Elbasan, Berat; (burimi: AGIS).
- Përmirësim i njohurive dhe teknologjive të kultivimit.
- Marzhe të larta fitimi.
- Importet vazhdojnë të konkurojnë prodhimin vendas.
- Burim i rëndësishëm të ardhurash.
- Eksporte relativisht të ulëta, për shkak se ka shumë pak ferma të specializuara vetëm në prodhimin e kungulleshkave, zakonisht prodhohet nga fermat mikse.

**Paketa teknologjike për prodhimin e kungulleshkave - Cikël i dimrit - Sipërfaqja 1 ha (inpute me shumicë)**

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim me belatriçe* | ha | 1 | **35,000** | 35,000 | 35,000 | | | | | *0.5* | 1.8% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 1.0% |
| 3 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 16 | **3,200** | 51,200 | 7,680 | 12,800 | 17,920 | 12,800 | | *0.7* | 2.6% |
| | Totali mekanikes bujqësore | | | | **106,200** | | | | | | ***1.4*** | **5.3%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Pastrim parcele/dezinfektim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 1.0% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | 10,000 | | | | | *0.1* | 0.5% |
| 3 | *Mbjellje e fidaneve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 1.0% |
| 4 | *Lidhje e bimëve* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | | 15,000 | 15,000 | | | *0.4* | 1.5% |
| 5 | *Shërbime gjate vegjetacionit* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | 28,000 | 84,000 | 84,000 | 84,000 | | *3.7* | 14.1% |
| 6 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 280 | **1,000** | 280,000 | | | 56,000 | 112,000 | 112,000 | *3.7* | 14.1% |
| 7 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | | | 8,000 | 16,000 | 16,000 | *0.5* | 2.0% |
| | Totali punimeve me krahë | | **680** | | **680,000** | | | | | | ***9.1*** | **34.2%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 10,000 | **24** | 240,000 | 240,000 | | | | | *3.2* | 12.1% |
| 2 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **110** | 77,000 | 77,000 | | | | | *1.0* | 3.9% |
| 3 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 1,000 | **230** | 230,000 | 34,500 | 57,500 | 80,500 | 57,500 | | *3.1* | 11.6% |
| 4 | *Plehëra gjethore* | kg | 10 | **1,670** | 16,700 | | | 5,010 | 6,680 | 5,010 | *0.2* | 0.8% |
| 5 | *PMB kundër demtuesve të tokës* | kg | 25 | **540** | 13,500 | 13,500 | | | | | *0.2* | 0.7% |
| 6 | *Fungicide* | kg | 20 | **5,000** | 100,000 | 15,000 | 25,000 | 35,000 | 25,000 | | *1.3* | 5.0% |
| 7 | *Insekticide* | kg | 8 | **8,000** | 64,000 | 9,600 | 16,000 | 22,400 | 16,000 | | *0.9* | 3.2% |
| 8 | *Bletë pjalmuese* | koshere | 6 | **13,000** | 78,000 | | | 78,000 | | | *1.0* | 3.9% |
| 9 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **5** | 30,000 | 30,000 | | | | | *0.4* | 1.5% |
| 10 | *Spango për lidhje* | copë | 5 | **4,000** | 20,000 | | 10,000 | 10,000 | | | *0.3* | 1.0% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **869,200** | | | | | | ***11.6*** | **43.7%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 1,800 | **14.0** | 25,200 | 5,040 | 5,040 | 5,040 | 5,040 | 5,040 | *0.3* | 1.3% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 3,000 | **5** | 15,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | 3,000 | *0.2* | 0.8% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 10 | **2,500** | 25,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | *0.3* | 1.3% |
| 4 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | *0.2* | 0.7% |
| 5 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **30,000** | 30,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | 6,000 | *0.4* | 1.5% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **109,200** | | | | | | ***1.5*** | **5.5%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e serrës* | lekë | | | 200,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | 40,000 | *2.7* | 10.1% |
| 2 | *Sigurimet shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *0.3* | 1.0% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.1* | 0.2% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **223,200** | | | | | | ***3.0*** | **11.2%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 1,764,600 | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 223,200 | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **1,987,800** | **637,960** | **283,980** | **475,510** | **393,660** | **196,690** | ***36.1*** | **100%** |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia I | | kg | 55,000 | **55** | 3,025,000 | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia II | | kg | 20,000 | **40** | 800,000 | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **3,825,000** | | | | | | | |
| ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | | ***1,837,200*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***26.5*** | | |
| ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | | ***38,976*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***51.0*** | | |
| ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | | ***110.29*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***48.0%*** | | |



# Karta teknologjike - Luleshtrydhe në serë - Impute me shumicë - Sipërfaqe 1 ha

Luleshtrydhja është një frut që ka filluar të shihet me prioritet, sidomos në 4 - 5 vitet e fundit. Shumë fermerë kanë ngurruar të kultivojnë luleshtrydhen në serra për shkak të kostove relativisht të larta fillestare, por duke parë fitimet e larta që mund të arrihen nga ky produkt interesi po rritet çdo ditë e më shumë. Duke qënë se do të analizojmë skenarin, kur fermerët bashkëpunojmë për blerjen e imputeve në mënyrë të përbashkët me shumicë, rëndësi do t'i kushtohet evidentimit të efekteve pozitive të kësaj mënyrë operimi mbi nivelin e fitimit, koston e prodhimit për njësi, etj.

## Kostot e prodhimit

Nga vlerësimet e kryera në konsultim me ekspertë dhe aktorë të ndryshëm, kostoja totale për kultivimin e 1 ha luleshtrydhe në serra është rreth 5 637 850 lekë. Nga totali i kostove 5 191 450 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 446 400 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve me 62.5% të totalit. Kostoja e dytë më e rëndësishmë është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 23.1% e totalit të kostove të prodhimit.

Pra, blerja e imputeve dhe materialeve së bashku me fuqinë punëtore përbëjnë më shumë se 3/4 e totalit të kostove. Kostot fikse janë 7.9% të totalit të kostove dhe pjesa e mbetur janë punime të mekanizuara dhe shpenzime të tjera.

**Struktura e kostove**




## Të ardhurat

Kultivimi i luleshtrydhes në serra gjeneron të ardhura të kënaqshme, duke rritur gjithnjë e me shumë interesin e investitorëve për kultivimin e këtij produkti. Kultivimi i luleshtrydhes në serra, në skenarin e imputeve me shumicë gjeneron një nivel prodhimi prej 55 ton dhe një të ardhur prej 9 150 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (40 ton), janë llogaritur me një çmim 180 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e dytë, (15 ton), me një çmim 130 lek/kg.

## Kreditimi

Luleshtrydhja në serra ka kosto relativisht të larta në fillim të sezonit të prodhimit. Kreditimi nevojitet kryesisht në muajin tetor, periudhë në të cilën fillon sezoni i prodhimit. Vjeljet fillojnë në janar dhe zgjasin deri në qershor. Një linjë kredie afatshkurtër, me pagesa jo të rregullta, është produkti i përshtatshëm bankar. Periudha më e përshtatshme për shlyerjen e kredisë është mars - qershor, periudhë në të cilën prodhimi dhe shitjet arrijnë kulmin.

**Grafiku kohor i kreditimit**




## Treguesit kryesorë

Efekte i blerjes së imputeve me shumicë në rastin e luleshtrydhes është më i lartë se perimet e serrave, kjo për aryse se edhe kostot e prodhimit për luleshtrydhën janë më të larta. Vërejmë një rritje me rreth 400 000 lekë të fitimit dhe nje reduktim me pothuajse 7 lekë të kostos së prodhimit për njësi.

- **Fitimi neto:** 3 512 150 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 33 889 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 42.31 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 102.5 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 38.4%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Preferencë e lartë e konsumatorëve për produktin vendas.
- Rritje e shpejtë e sipërfaqeve të kultivuara dhe prodhimit.
- Rajonet kryesore: Fier + 90%, Durrës; (burimi: AGIS).
- Interes i lartë për investime të reja.
- Marzhe të larta fitimi.
- Burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje.
- Kërkesa nga tregjet perëndimore në rritje të vazhdueshme.
- Rritje eksponenciale e eksporteve, (dhjetëfishim në pesë vitet e fundit; eksportet në vitin 2016 ishin 982 ton ose rreth 1 milion Euro).

| Paketa teknologjike për prodhimin e luleshtrydhes - Sipërfaqja 1 ha (inpute me shumicë) | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
| | | | | | | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim* | ha | 1 | **16,000** | 16,000 | 16,000 | | | | | | | | | *1.1* | 0.3% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **20,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | *1.3* | 0.4% |
| 3 | *Përgatitja e vllajave* | ha | 1 | **45,000** | 45,000 | 45,000 | | | | | | | | | *3.0* | 0.8% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **81,000** | | | | | | | | | | ***5.4*** | **1.4%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Shpendarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | | | *2.0* | 0.5% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 7 | **1,000** | 7,000 | 7,000 | | | | | | | | | *0.5* | 0.1% |
| 3 | *Ngritja e tuneleve, shtrimi i plasmasit të mulçerimit dhe shtrirja e sistemit të ujitjes* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | | | | | *1.3* | 0.4% |
| 4 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | 40,000 | | | | | | | | | *2.7* | 0.7% |
| 5 | *Spërkatje me pompë shpine* | ditë pune | 43 | **1,000** | 43,000 | 4,300 | 4,300 | 4,300 | 6,450 | 6,450 | 6,450 | 6,450 | 4,300 | | *2.9* | 0.8% |
| 6 | *Sherbime gjatë vegjetacionit (këputja e luleve, heqja e stoloneve dhe gjetheve të vjetra)* | ditë pune | 500 | **1,000** | 500,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | 75,000 | | *33.3* | 8.9% |
| 7 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 600 | **1,000** | 600,000 | | | | 30,000 | 48,000 | 90,000 | 150,000 | 180,000 | 102,000 | *40.0* | 10.6% |
| 8 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 60 | **1,000** | 60,000 | | | | 3,000 | 4,800 | 9,000 | 15,000 | 18,000 | 10,200 | *4.0* | 1.1% |
| | Totali punimeve me krahë | | **1,300** | | **1,300,000** | | | | | | | | | | ***86.7*** | **23.1%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 75,000 | **22** | 1,650,000 | 1,650,000 | | | | | | | | | *110.0* | 29.3% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 100 | **1,500** | 150,000 | 150,000 | | | | | | | | | *10.0* | 2.7% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 700 | **110** | 77,000 | 77,000 | | | | | | | | | *5.1* | 1.4% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 1,400 | **230** | 322,000 | | 48,300 | 48,300 | 48,300 | 48,300 | 48,300 | 48,300 | 32,200 | | *21.5* | 5.7% |
| 5 | *Plehëra gjethore* | kg | 25 | **1,670** | 41,750 | | | | 8,350 | 8,350 | 8,350 | 8,350 | 8,350 | | *2.8* | 0.7% |
| 6 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **540** | 13,500 | 13,500 | | | | | | | | | *0.9* | 0.2% |
| 7 | *Fungicide* | kg | 40 | **5,000** | 200,000 | | 20,000 | 20,000 | 20,000 | 30,000 | 40,000 | 40,000 | 30,000 | | *13.3* | 3.5% |
| 8 | *Insekticide* | kg | 12 | **8,000** | 96,000 | | 9,600 | 9,600 | 9,600 | 14,400 | 19,200 | 19,200 | 14,400 | | *6.4* | 1.7% |
| 9 | *Plasmas për mulçerim* | m2 | 6,000 | **5** | 30,000 | 30,000 | | | | | | | | | *2.0* | 0.5% |
| 10 | *Arka ambalazhi* | copë | 9,000 | **47** | 423,000 | | | | 21,150 | 33,840 | 63,450 | 105,750 | 126,900 | 71,910 | *28.2* | 7.5% |
| 11 | *Kupa (9 copëshe)* | copë | 9,000 | **58** | 522,000 | | | | 26,100 | 41,760 | 78,300 | 130,500 | 156,600 | 88,740 | *34.8* | 9.3% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **3,525,250** | | | | | | | | | | ***235.0*** | **62.5%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 4,800 | **14.0** | 67,200 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 6,720 | 13,440 | 6,720 | *4.5* | 1.2% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 8,000 | **5** | 40,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 8,000 | 4,000 | *2.7* | 0.7% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rruge | 20 | **2,500** | 50,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 7,500 | 7,500 | 5,000 | *3.3* | 0.9% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | | | *5.6* | 1.5% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | | | *0.9* | 0.2% |
| 6 | *Të paparishikuara* | leke | 1 | **30,000** | 30,000 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,300 | 3,600 | *2.0* | 0.5% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **285,200** | | | | | | | | | | ***19.0*** | **5.1%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e tuneleve* | lekë | | | 400,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 44,000 | 48,000 | *26.7* | 7.1% |
| 2 | *Sigurimet shoqërore* | lekë | | | 38,400 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,224 | 4,608 | *2.6* | 0.7% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 8,000 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 880 | 960 | *0.5* | 0.1% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **446,400** | | | | | | | | | | ***29.8*** | **7.9%** |
| | Total i kostove variable (A+B+C+D) | leke | | | 5,191,450 | | | | | | | | | | | |
| | Total i kostove fikse (E) | leke | | | 446,400 | | | | | | | | | | | |
| | **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | leke | | | **5,637,850** | **2,318,924** | **200,324** | **200,324** | **291,074** | **379,024** | **506,174** | **669,174** | **727,094** | **345,738** | ***102.5*** | 100% |
| | Të ardhurat nga shitjet cilësia e parë | kg | 40,000 | **180** | 7,200,000 | | | | | | | | | | | |
| | Të ardhurat nga shitjet cilësia e dytë | kg | 15,000 | **130** | 1,950,000 | | | | | | | | | | | |
| | **Të ardhurat totale** | leke | | | **9,150,000** | | | | | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | ***3,512,150*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***102.5*** | | | | | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***33,889*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***166.4*** | | | | | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***42.31*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***38.4%*** | | | | | | |

Shënime:

# KARTAT TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMEVE NË FUSHË INPUTE ME PAKICË



# Karta teknologjike - Domate fushe - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Pavarësisht rritjes së shpejtë të sipërfaqes me serra në Shqipëri, prodhimi në fushë të hapur dominon strukturën e prodhimit të domates dhe pothuajse të gjitha perimeve të tjera. Perveç Fierit dhe Beratit, kur prodhimi i domates në serra është më i lartë se prodhimi në fushë të hapur, në të gjitha rajonet e tjera të vendit dominon prodhimi në fushë të hapur. Një arsye mund të jetë së pavarësisht fitimeve të larta, ndërtimi i serrave kërkon një investim të lartë fillestar. Për shkak të peshës që zë prodhimi në fushë të hapur për domaten, njohja e stukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve është shumë e rëndësishme për aktorë të ndryshëm të përfshirë në këtë sektor. Përveç të ardhurave dhe shpenzimeve do të analizohen shkurtimisht edhe disa tregues të rëndësishëm.

## Kostot e prodhimit

Kostot e prodhimit të domates në fushë të hapur janë ndjeshëm më të ulëta, se kultivimi në ambjente të mbrojtura. Nga vlerësimet e kryera, kostoja totale për kultivimin e 1 ha domate në fushë të hapur është rreth 1 325 400 lekë. Nga totali i kostove 1 282 200 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit ndërsa 43 200 lekë janë kosto fikse. Në strukturën e shpenzimeve, peshën më të madhe e zë kostoja e blerjes së imputeve të nevojshme me 54.2% të totalit të kostove. Kosto e dytë më e rëndësishmë është kostoja e fuqisë punëtore që zë rreth 27.4% të totalit të kostove të prodhimit.

Kostot fikse në rastin e prodhimit të domates në fushë të hapur janë të papërfillshme, (3.3% e totalit), dhe përbëhen nga amortizimi i serrës, sigurimet shoqërore dhe taksa e tokës.

**Struktura e kostove**




## Të ardhurat

Kultivimi i domates në fushë të hapur gjeneron të ardhura më të ulëta se prodhimi në serra, megjithatë mbetet një burim i rëndësishëm të ardhurash për shumë familje. Kultivimi i domates në fushë të hapur në skenarin e imputeve me pakicë gjeneron një nivel prodhimi prej 70 ton dhe një të ardhur prej 1 610 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (50 ton), janë llogaritur më një çmim 25 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e , (20 ton), me një çmim 18 lek/kg.

## Kreditimi

Duke qenë se shërbimet agroteknike fillojnë në prill, fermerët kanë nevojë për kapital në fund të muajit mars, në mënyrë që të përballojnë shpenzimet e blerjes së fidanëve dhe imputeve. Vjelja dhe shitja e produktit fillon në qershor dhe vazhdon deri në gusht të çdo viti. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku kohor i kreditimit**




## Treguesit kryesorë

Megjithëse kostot e prodhimit në fushë të hapur janë shumë më të ulëta se prodhimi në serrë, po ashtu është edhe marzhi i fitimit dy herë më i ulët. Fitimi neto është 284 600 lekë/ha, ndërsa kostoja e prodhimit është 18.9 kg/ha.

- **Fitimi neto:** 284 600 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 57 626 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 192.84 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 18.9 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 17.7%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Produkti më i rëndësishëm në grupin e perimeve në terma të prodhimit dhe konsumit.
- Traditë e vjetër në kultivim e domates në fushë të hapur.
- Rajonet kryesore: Fier, Tiranë, Elbasan, Durrës, Korçë, (burimi: AGIS).
- Dominon strukturën e prodhimit në të gjithë qarqet e Shqipërisë, me përjashtim të Fierit dhe Beratit, ku prodhimi në serra e tejkalon prodhimin në fushë të hapur.
- Furnizon kryesisht tregun vendas; domatja që eksportohet është domate sere.
- Kostot e ulëta të kultivimit ofrojnë mundësi kultivimi edhe për fermat e vogla.

**Paketa teknologjike për prodhimin e domatës në fushë të hapur - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë)**

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim* | ha | 1 | **15,000** | 15,000 | 15,000 | | | | | *0.2* | 1.1% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **12,000** | 12,000 | 12,000 | | | | | *0.2* | 0.9% |
| 3 | *Hapje e vijave kulluese* | copë | 3 | **700** | 2,100 | 2,100 | | | | | *0.03* | 0.2% |
| 4 | *Shpërndarje e plehut me centrifugë* | ha | 1 | **2,000** | 2,000 | 2,000 | | | | | *0.03* | 0.2% |
| 5 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 14 | **3,500** | 49,000 | 12,250 | 12,250 | 12,250 | 12,250 | | *0.7* | 3.7% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **80,100** | | | | | | ***1.1*** | **6.0%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Shpëndarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | *0.4* | 2.3% |
| 2 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 1.5% |
| 3 | *Shtrirja e sistemit të ujitjes* | ditë pune | 3 | **1,000** | 3,000 | 3,000 | | | | | *0.0* | 0.2% |
| 4 | *Shërbime gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 150 | **1,000** | 150,000 | 45,000 | 45,000 | 30,000 | 30,000 | | *2.1* | 11.3% |
| 5 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 140 | **1,000** | 140,000 | | | 35,000 | 56,000 | 49,000 | *2.0* | 10.6% |
| 6 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | | | 5,000 | 8,000 | 7,000 | *0.3* | 1.5% |
| | Totali punimeve me krahë | | **363** | | **363,000** | | | | | | ***5.2*** | **27.4%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 40,000 | **12** | 480,000 | 480,000 | | | | | *6.9* | 36.2% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 50 | **1,660** | 83,000 | 83,000 | | | | | *1.2* | 6.3% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 200 | **130** | 26,000 | 26,000 | | | | | *0.4* | 2.0% |
| 4 | *Plëhera kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 100 | **280** | 28,000 | 7,000 | 7,000 | 7,000 | 7,000 | | *0.4* | 2.1% |
| 5 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 26 | **650** | 16,900 | 16,900 | | | | | *0.2* | 1.3% |
| 6 | *Fungicide* | kg | 8 | **6,000** | 48,000 | 12,000 | 12,000 | 12,000 | 12,000 | | *0.7* | 3.6% |
| 7 | *Insekticide* | kg | 4 | **9,000** | 36,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | | *0.5* | 2.7% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **717,900** | | | | | | ***10.3*** | **54.2%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 1,800 | **14.0** | 25,200 | 3,780 | 5,040 | 6,300 | 6,300 | 3,780 | *0.4* | 1.9% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 3,000 | **5** | 15,000 | 2,250 | 3,000 | 3,750 | 3,750 | 2,250 | *0.2* | 1.1% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 2 | **2,500** | 5,000 | 750 | 1,000 | 1,250 | 1,250 | 750 | *0.1* | 0.4% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 50 | **840** | 42,000 | 42,000 | | | | | *0.6* | 3.2% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | *0.2* | 1.1% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **20,000** | 20,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | *0.3* | 1.5% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **121,200** | | | | | | ***1.7*** | **9.1%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e sistemit të ujitjes* | lekë | | | 20,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | *0.3* | 1.5% |
| 2 | *Sigurime shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *0.3* | 1.4% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.1* | 0.3% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **43,200** | | | | | | ***0.6*** | **3.3%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 1,282,200 | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 43,200 | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **1,325,400** | **850,670** | **106,930** | **134,190** | **158,190** | **75,420** | ***18.9*** | **100%** |
| Te ardhurat nga shitjet cilësia e parë | | kg | 50,000 | **25** | 1,250,000 | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia e dytë | | kg | 20,000 | **18** | 360,000 | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **1,610,000** | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | ***284,600*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***18.9*** | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***57,626*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***23.0*** | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***192.84*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***17.7%*** | | |



# Karta teknologjike - Kastravec serre - Kulturë e parë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Duke qënë produkti i dytë më e rëndësishëm i kultivuar në mjedise të mbrojtura pas domates, njohja e shpenzimeve dhe të ardhurave për këtë kulturë përbën rëndësi të veçantë për shumë aktorë, përfshi edhe vetë fermerët. Në këte seksion trajtohet struktura e kostove të prodhimit dhe të ardhurat për kultivimin e kastrevecit në serra, kulturë e parë në skenarin e blerjes së imputeve me pakicë në sipërfaqe 1 hektar. Gjithashtu analizohet nevoja për kreditim, treguesit kryesorë ekonomikë, si edhe karakteristikat dhe potencialet e kastravecit në serra.

## Kostot e prodhimit

Kultivimi i kastravecit në fushë të hapur në një sipërfaqe prej 1 ha duke përdorur impute me pakicë ka një kosto totale prej 1 318 750 lekë. Nga totali i kostove 1 275 550 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 43 200 lekë janë kosto fikse. Blerja e imputeve dhe materialeve zënë pjesën më të madhe në strukturën e kostove me 54.4%, ndjekur nga kostot e fuqisë punëtore me 26.5%.

Njësoj si në rastin e domates në fushë të hapur, edhe në rastin e kastravecit kostot fikse janë janë të papërfillshme në strukturën e kostos totale. Kostot fikse kanë të bëjnë me amortizimin e sistemit të ujitjes, sigurimet shoqërore dhe pagesën e taksës së tokës.

### Struktura e kostove




## Të ardhurat

Kultivimi i kastravecit në fushë të hapur ka një rendiment mesatar prej 60 ton/ha. Fermerët duhet t'i kushtojnë shumë rëndësi cilësisë, në mënyrë që të shmangin sa më shumë cilësine e dytë, të cilën janë të detyruar ta shesin më një çmim më të ulët se kostoja e prodhimit për njësi. Kultivimi i kastravecit në fushë të hapur në një sipërfaqe prej 1 ha gjeneron një nivel ardhurash prej 1 600 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (40 ton), janë llogaritur me një çmim 30 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e dytë, (20 ton), me një çmim 20 lek/kg.

## Kreditimi

Cikli i prodhimit të kastravecit në fushë të hapur është i njëjtë me domaten. Kostot e prodhimit janë pak a shumë të njëjta, ç'ka nënkupton nevoja të ngjashme për kreditim. Duke qënë se cikli i prodhimit fillon në prill, fermerët kanë nevojë për kreditim në fund të muajti mars. Koha më e mirë për shlyerjen e kredisë është gjatë sezonit të vjeljes dhe shitjes së produktit në periudhën qershor - gusht. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

### Grafiku kohor i kreditimit




## Treguesit kryesorë

Kultivimi i kastravecit në fushë të hapur gjeneron një fitim neto prej 281 550 lekë/ha ose një marzh fitimi 17.6%. Rendimenti në pikën kritike është 49 453 kg/ha, bazuar në çmimin mesatar të shitjes dhe kostoja e prodhimit është 22.0 lekë/kg.

- **Fitimi neto:** 281 250 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 49 453 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 171.43 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 22.0 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 17.6%.

## Karakteristika dhe potenciale

- Njohuri të mira dhe eksperiencë e gjatë për kultivimin në fushë të hapur.
- Rajonet kryesore: Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Dibër, (burimi: AGIS).
- Vlera të larta ushqimore dhe kontribut për industrinë e përpunimit.
- Kosto të ulëta prodhimi.
- Kryesisht furnizon tregun shqiptar, (eksportet janë prodhim serre).
- Preferencë a lartë e konsumatorëve për produktin vendas.

**Paketa teknologjike për prodhimin e kastravecit në fushe të hapur - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë)**

| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim* | ha | 1 | **15,000** | 15,000 | 15,000 | | | | | *0.3* | 1.1% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **12,000** | 12,000 | 12,000 | | | | | *0.2* | 0.9% |
| 3 | *Hapje e vijave kulluese* | copë | 3 | **700** | 2,100 | 2,100 | | | | | *0.0* | 0.2% |
| 4 | *Shpërndarje e plehut me centrifugë* | ha | 1 | **2,000** | 2,000 | 2,000 | | | | | | |
| 5 | *Spërkatje me pompë centrifugale* | nr | 16 | **3,500** | 56,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | 14,000 | | *0.9* | 4.2% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **87,100** | | | | | | ***1.5*** | **6.6%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Shpëndarje e plehut organik* | ditë pune | 30 | **1,000** | 30,000 | 30,000 | | | | | *0.5* | 2.3% |
| 2 | *Shpërndarje e plehut inorganik bazë* | ditë pune | 7 | **1,000** | 7,000 | 7,000 | | | | | *0.1* | 0.5% |
| 3 | *Mbjellje e fidanëve* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | 20,000 | | | | | *0.3* | 1.5% |
| 4 | *Shtrirja e sistemit të ujitjes* | ditë pune | 3 | **1,000** | 3,000 | 3,000 | | | | | *0.1* | 0.2% |
| 5 | *Shërbime gjate vegjetacionit* | ditë pune | 150 | **1,000** | 150,000 | 45,000 | 45,000 | 30,000 | 30,000 | | *2.5* | 11.4% |
| 6 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 120 | **1,000** | 120,000 | | | 30,000 | 48,000 | 42,000 | *2.0* | 9.1% |
| 7 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 20 | **1,000** | 20,000 | | | 5,000 | 8,000 | 7,000 | *0.3* | 1.5% |
| | Totali punimeve me krahë | | **350** | | **350,000** | | | | | | ***5.8*** | **26.5%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Fidanë* | copë | 40,000 | **12** | 480,000 | 480,000 | | | | | *8.0* | 36.4% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 50 | **1,660** | 83,000 | 83,000 | | | | | *1.4* | 6.3% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 200 | **130** | 26,000 | 26,000 | | | | | *0.4* | 2.0% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 100 | **280** | 28,000 | 7,000 | 7,000 | 7,000 | 7,000 | | *0.5* | 2.1% |
| 5 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | *0.3* | 1.2% |
| 6 | *Fungicide* | kg | 8 | **6,000** | 48,000 | 12,000 | 12,000 | 12,000 | 12,000 | | *0.8* | 3.6% |
| 7 | *Insekticide* | kg | 4 | **9,000** | 36,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | 9,000 | | *0.6* | 2.7% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **717,250** | | | | | | ***12.0*** | **54.4%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 1,800 | **14.0** | 25,200 | 3,780 | 5,040 | 6,300 | 6,300 | 3,780 | *0.4* | 1.9% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 3,000 | **5** | 15,000 | 2,250 | 3,000 | 3,750 | 3,750 | 2,250 | *0.3* | 1.1% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 2 | **2,500** | 5,000 | 750 | 1,000 | 1,250 | 1,250 | 750 | *0.1* | 0.4% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 50 | **840** | 42,000 | 42,000 | | | | | *0.7* | 3.2% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | *0.2* | 1.1% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **20,000** | 20,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | *0.3* | 1.5% |
| | Totali i shpenzimeve të tjera | | | | **121,200** | | | | | | ***2.0*** | **9.2%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e sistemit të ujitjes* | lekë | | | 20,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | *0.3* | 1.5% |
| 2 | *Sigurime shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | 3,840 | *0.3* | 1.5% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 4,000 | 800 | 800 | 800 | 800 | 800 | *0.1* | 0.3% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **43,200** | | | | | | ***0.7*** | **3.3%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 1,275,550 | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 43,200 | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **1,318,750** | **858,770** | **108,680** | **130,940** | **151,940** | **68,420** | **22.0** | **100%** |
| Te ardhurat nga shitjet cilësia e parë | | kg | 40,000 | **30** | 1,200,000 | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia e dytë | | kg | 20,000 | **20** | 400,000 | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **1,600,000** | | | | | | | |
| | ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | ***281,250*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***22.0*** | | |
| | ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | ***49,453*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***26.7*** | | |
| | ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | ***171.43*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***17.6%*** | | |



# Karta teknologjike - Karrotë - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Karrota është një produkt i rëndësishëm me vlerta të larta ushqimore dhe kuruese që po kultivohet gjithnjë e më shumë në Shqipëri. Karrota kultivohet gjerësisht në Qarkun e Fierit që prodhon mbi 90% të karrotës në nivel kombëtar. Duke qenë se ka një rritje të interesit për kultivimin e karrotës, njohja e strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve është e rëndësishme për fermerët e rinj, por edhe për ofruesit e shërbimeve, si institucionet kredituese dhe ato politikëbërëse. Në këtë seksion do të trajtohen edhe disa tregues të rëndësishëm, të cilët e referohen kultivimit të karrotës në një sipërfaqe 1 hektar dhe blerjen e imputeve me pakicë.

**Kostot e prodhimit**

Kultivimi i karrotës në një sipërfaqe prej 1 ha duke përdorur impute me pakicë ka një kosto totale prej 844 750 lekë. Struktura e kostove dominohet nga kostot variabël të lidhura direkt me prodhimin, të cilat janë 797 550 lekë. Ndërsa kostot variable janë të parëndësishme në strukturën e kostos totale më një vlerë prej 47 200 lekë. Blerja e imputeve dhe materialeve zënë pjesën më të madhe në strukturën e kostove me 42.1%, ndjekur nga kostot e fuqisë punëtore me 28.5%. Punimet e mekanizuara të cilat kryhen në fillim të procesit të prodhimit dhe zënë 4.5% të kostos totale, ndërsa shpenzimet e tjera 19.3%. Shpenzimet e tjera kanë të bëjnë me energjinë elektrike, ujin, transportin, analizat e tokës, etj.

**Struktura e kostove**




**Të ardhurat**

Kultivimi i karrotës ka një rendiment mesatar prej 50 ton/ha. Fermerët duhet t'i kushtojnë shumë rëndësi cilësisë në mënyrë që të shmangin sa më shumë cilësinë e dytë, të cilën janë të detyruar ta shesin më një çmim që është shumë afër kostos së prodhimit. Kultivimi i karrotës në një sipërfaqe prej 1 ha gjeneron një nivel ardhurash prej 1 145 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (35 ton), janë llogaritur me një çmim 25 lek/kg ndërsa shitjet nga cilësia e dytë, (15 ton), me një çmim 18 lek/kg.

**Kreditimi**

Cikli i prodhimit të karrotës fillon në gusht dhe përfundon në mars. Pikërisht në fillim të muajit gusht, fermerët mund të kenë nevojë për kredi afatshkurtëra si kapital qarkullues për të përballuar kostot e prodhimit. Vjelja e karrotës fillon në muajin nëntor dhe vazhdon deri në muajin mars. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku kohor i kreditimit**




**Treguesit kryesorë**

Sinjali më i rëndësishëm për fermerët që kultivojnë apo planifikojnë të kultivojnë karrotë është se, për të shmangur humbjen duhet të arrijnë një rendiment jo më të vogël se 36 889 kg/ha bazuar në çmimin mesatar të shitjes dhe të shesin me një çmim jo më të ulët se 16.9 lek/kg, duke pasur parasysh rendimentin e arritur.

- **Fitimi neto:** 300 250 lekë/ha.
- **Rendimenti në pikën kritike:** 36 889 kg/ha.
- **Produktiviteti i punës:** 207.47 kg/ditë pune.
- **Kostoja e prodhimit:** 16.9 lekë/kg.
- **Marzhi neto i fitimit:** 26.2%.

**Karakteristika dhe potenciale**

- Produkti me vlera të larta ushqimore dhe kuruese.
- Dyfishim i prodhimit në 5 vitet e fundit, (nga 7 000 ton në 14 000 ton).
- Rajonet kryesore: Fier: (92.5% e totalit); Shkodër, Durrës, Dibër, Korçë, (burimi: AGIS).
- Kosto të ulëta prodhimi.
- Kryesisht furnizon tregun shqiptar.
- Eksportet të luhatshme nga viti në vit; kryesisht në Serbi, Kosovë dhe Maqedoni.
- Preferencë a lartë e konsumatorëve për produktin vendas.

| Paketa teknologjike për prodhimin e karrotës - Sipërfaqja 1 ha (inpute me pakicë) | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi i zërave të kostos | Njësia | Sasia | Çmimi/njësi | Vlera/lekë | Shpenzimet të ndara në muaj (lekë) | | | | | | | | Kosto prodhimi (lekë/kg) | Pesha e çdo zëri në shpenzime % |
| | | | | | | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Janar | Shkurt | Mars | | |
| | ***Punime të mekanizuara*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Plugim* | ha | 1 | **15,000** | 15,000 | 15,000 | | | | | | | | *1.0* | 1.8% |
| 2 | *Frezim* | ha | 1 | **12,000** | 12,000 | 12,000 | | | | | | | | *0.8* | 1.4% |
| 3 | *Hapje e vijave kulluese* | copë | 3 | **700** | 2,100 | 2,100 | | | | | | | | *0.1* | 0.2% |
| 4 | *Shpërndarje e plehut me centrifugë* | ha | 1 | **2,000** | 2,000 | 2,000 | | | | | | | | *0.1* | 0.2% |
| 5 | *Mbjellje me makinë* | ha | 1 | **7,000** | 7,000 | 7,000 | | | | | | | | *0.5* | 0.8% |
| | Totali mekanikës bujqësore | | | | **38,100** | | | | | | | | | ***2.5*** | **4.5%** |
| | ***Punime me krahë*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Shpërndarje e plehut organik* | ditë pune | 60 | **1,000** | 60,000 | 60,000 | | | | | | | | *4.0* | 7.1% |
| 2 | *Shtrirja e sistemit të ujitjes* | ditë pune | 3 | **1,000** | 3,000 | 3,000 | | | | | | | | *0.2* | 0.4% |
| 3 | *Spërkatje me pompë shpine* | ditë pune | 8 | **1,000** | 8,000 | 800 | 800 | 800 | 1,200 | 1,600 | 1,600 | 1,200 | | *0.5* | 0.9% |
| 4 | *Sheërbime të tjera gjatë vegjetacionit* | ditë pune | 40 | **1,000** | 40,000 | 4,000 | 4,000 | 4,000 | 6,000 | 8,000 | 8,000 | 6,000 | | *2.7* | 4.7% |
| 5 | *Vjelje prodhimi* | ditë pune | 120 | **1,000** | 120,000 | | | | 18,000 | 24,000 | 24,000 | 30,000 | 24,000 | *8.0* | 14.2% |
| 6 | *Ngarkim shkarkim* | ditë pune | 10 | **1,000** | 10,000 | | | | 1,500 | 2,000 | 2,000 | 2,500 | 2,000 | *0.7* | 1.2% |
| | Totali punimeve me krahë | | **241** | | **241,000** | | | | | | | | | ***16.1*** | **28.5%** |
| | ***Inpute/materiale*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Farë* | kg | 5 | **20,000** | 100,000 | 100,000 | | | | | | | | *6.7* | 11.8% |
| 2 | *Pleh organik i kompostuar* | ton | 100 | **1,660** | 166,000 | 166,000 | | | | | | | | *11.1* | 19.7% |
| 3 | *Plehëra inorganike bazë NPK* | kg | 200 | **130** | 26,000 | 26,000 | | | | | | | | *1.7* | 3.1% |
| 4 | *Plehëra kristalore NPK + mikroelementë* | kg | 100 | **260** | 26,000 | | 3,900 | 3,900 | 3,900 | 5,200 | 5,200 | 3,900 | | *1.7* | 3.1% |
| 5 | *PMB kundër dëmtuesve të tokës* | kg | 25 | **650** | 16,250 | 16,250 | | | | | | | | | |
| 6 | *Fungicide* | kg | 2 | **6,000** | 12,000 | | 1,800 | 1,800 | 1,800 | 2,400 | 2,400 | 1,800 | | *0.8* | 1.4% |
| 7 | *Insekticide* | kg | 1 | **9,000** | 9,000 | | 1,350 | 1,350 | 1,350 | 1,800 | 1,800 | 1,350 | | *0.6* | 1.1% |
| | Totali inputeve/materialeve | | | | **355,250** | | | | | | | | | ***23.7*** | **42.1%** |
| | ***Shpenzime të tjera*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Energji elektrike* | kwh | 1,800 | **14.0** | 25,200 | 5,040 | 5,040 | 2,520 | 2,520 | 2,520 | 2,520 | 2,520 | 2,520 | *1.7* | 3.0% |
| 2 | *Ujë* | m3 | 3,000 | **5** | 15,000 | 3,000 | 3,000 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | *1.0* | 1.8% |
| 3 | *Transport i inputeve në fermë* | rrugë | 2 | **2,500** | 5,000 | 1,000 | 1,000 | 500 | 500 | 500 | 500 | 500 | 500 | *0.3* | 0.6% |
| 4 | *Transporti i plehut organik* | ton | 100 | **840** | 84,000 | 84,000 | | | | | | | | *5.6* | 9.9% |
| 5 | *Analiza e tokës dhe e ujit* | nr | 2 | **7,000** | 14,000 | 14,000 | | | | | | | | *0.9* | 1.7% |
| 6 | *Të paparishikuara* | lekë | 1 | **20,000** | 20,000 | 4,000 | 4,000 | 2,000 | 2,000 | 2,000 | 2,000 | 2,000 | 2,000 | *1.3* | 2.4% |
| | Totali i shpenzimeve te tjera | | | | **163,200** | | | | | | | | | ***10.9*** | **19.3%** |
| | ***Kosto fikse*** | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | *Kosto amortizimi e sistemit të ujitjes* | lekë | | | 20,000 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | 2,500 | *1.3* | 2.4% |
| 2 | *Sigurime shoqërore* | lekë | | | 19,200 | 2,400 | 2,400 | 2,400 | 2,400 | 2,400 | 2,400 | 2,400 | 2,400 | *1.3* | 2.3% |
| 3 | *Taksa e tokës* | lekë | | | 8,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | 1,000 | *0.5* | 0.9% |
| | Totali i kostove fikse | | | | **47,200** | | | | | | | | | ***3.1*** | **5.6%** |
| Total i kostove variable (A+B+C+D) | | lekë | | | 797,550 | | | | | | | | | | |
| Total i kostove fikse (E) | | lekë | | | 47,200 | | | | | | | | | | |
| **Totali i shpenzimeve (A+B+C+D+E)** | | lekë | | | **844,750** | **531,090** | **30,790** | **24,270** | **46,170** | **57,420** | **57,420** | **59,170** | **38,420** | ***16.9*** | **100%** |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia e parë | | kg | 35,000 | **25** | 875,000 | | | | | | | | | | |
| Të ardhurat nga shitjet cilësia e dytë | | kg | 15,000 | **18** | 270,000 | | | | | | | | | | |
| **Të ardhurat totale** | | lekë | | | **1,145,000** | | | | | | | | | | |
| ***Fitim neto (lekë/ha)*** | | | | | ***300,250*** | ***Kosto e prodhimit (lekë/kg)*** | | | | ***16.9*** | | | | | |
| ***Rendimenti në pikën kritike (kg/ha)*** | | | | | ***36,889*** | ***Çmimi mesatar i shitjes (lekë/kg)*** | | | | ***22.9*** | | | | | |
| ***Produktiviteti i punës (kg/ditë pune)*** | | | | | ***207.47*** | ***Marzhi i fitimit*** | | | | ***26.2%*** | | | | | |



# Karta teknologjike - Lulelakër - Impute me pakicë - Sipërfaqe 1 ha

Lulelakra është një produkt i rëndësishëm në grupin e perimeve dhe kultivohet gjerësisht në qarkun e Fierit, i cili prodhon 70% të lulelakrës në nivel kombëtar. Interesi për kultivimin e lulelakrës po rritet ndjeshëm edhe në zona të tjera të Shqipërisë. Në këtë seksion do të analizohet struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve për kultivimin e lulelakrës në fushë të hapur, në një sipërfaqe prej 1 hektar në rastin e blerjes së imputeve me pakicë. Gjithashtu do të analizohen shkurtimisht disa tregues të konsideruar të rëndësishëm për fermerët, por edhe për grupet e tjera të interesit.

**Kostot e prodhimit**

Kultivimi i lulelakrës në fushë të hapur në një sipërfaqe prej 1 ha duke përdorur impute me pakicë ka një kosto totale prej 762 750 lekë. Nga totali i kostove 715 050 lekë janë kosto variabël që ndikohen direkt nga niveli i prodhimit, ndërsa 47 200 lekë janë kosto fikse. Blerja e imputeve dhe materialeve zënë pjesën më të madhe në strukturën e kostove me 43.5%, ndjekur nga kostot e fuqisë punëtore me 30.3%.

Njësoj si për pjesën më të madhe të perimeve në fushë të hapur, edhe në rastin e lulelakrës kostot fikse janë të papërfillshme në strukturën e kostove totale me vetëm 6.2%. Shpenzimet e tjera lidhen me energjinë elektrike, ujin, shpenzime transporti, analiza toke, etj.

**Struktura e kostove**




**Të ardhurat**

Kultivimi i lulelakrës ofron rendimente të mira prodhimi, duke arritur një mesatare prej 20 ton/ha. Duke mos pasur kapacitetet e duhura për një cilësi maksimale, një pjesë e produktit shitet si cilësi e dytë me çmim më të ulët. Kultivimi i lulelakrës në fushë të hapur në një sipërfaqe prej 1 ha gjeneron një nivel ardhurash prej 1 210 000 lekë. Shitjet nga cilësia e parë, (14 ton), janë llogaritur me një çmim 65 lek/kg, ndërsa shitjet nga cilësia e , (6 ton), me një çmim 50 lek/kg.

**Kreditimi**

Cikli i prodhimit të lulelakrës është i ngjashëm me atë të karrotës. Procesi i prodhimit nis në gusht, ndërsa vjelja dhe shitja e produktit fillon në nëntor dhe vazhdon deri në mars. Pikërisht në fillim të muajit gusht fermat mund të kenë nevojë për kredi të vogla afatshkurtëra në formën e kapitalit qarkullues. Bankat në fazën e përcaktimit të planit të pagesës për shlyerjen e kredisë, duhet të marrin parasysh ciklin e vjeljes dhe shitjes së produktit si në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku kohor i kreditimit**




**Treguesit kryesorë**

Konkluzioni më i rëndësishëm nga interpretimi i treguesve të llogaritur është: fermat që prodhojnë lulelakër për të shmangur humbjet duhet të sigurojnë një rendiment minimal prej 12 599 kg/ha duke pasur çmimin mesatar të shitjes dhe të shesin me një çmim jo më të vogël se 38.1 lek/kg bazuar në rendimentin e arritur.

